

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D.



RAPORT VJETOR

'09



korrik 2010

Raport vjetor 2009

Përmbajtja

Lista e tabelave	4
Lista e figurave	5
Lista e shkurtesave dhe akronimeve	6
Të dhënat themelore për kompaninë	8
Fjala e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve	9
Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT	10
Harta e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës 400/220/110 kV	12
Raporti i Auditorit të Pavarur	13
KOSTT sh.a	15
Objektivat e kompanisë për vitin 2010	17
Qeverisja dhe Organizimi në KOSTT	19
Bordi i Drejtorëve	19
Menaxhmenti i lartë në Kostt	19
Struktura Organizative e KOSTT	20
Roli i Komisionit të Auditimit	22
Komisioni i Auditimit	22
Korniza ligjore dhe rregullative	22
Korniza rregullative	23
Amendimet e Kodeve Teknike	23
Plani Zhvillimor i Transmisionit	24
Zhvillimi i sistemit tarifor të transmisionit	25
Marrëdhëniet efektive me palët e treta dhe transparenca	26
Pasqyrë e Operimit të Rrjetit të Transmisionit të Kosovës	29
Mirëmbajtja 2009	29
Zhvillimi dhe avancimi i Rrjetit të transmisionit të Sistemit Elektrik të Kosovës	39
Zhvillimi i Rrjetit Transmetues	39
Projektet në rrjetin e Transmisionit (2009)	39
Zhvillimet në kapacitetet gjeneruese	42
Zhvillimi i interkoneksionit me vendet fqinje	42
Zhvillimet e infrastrukturës për kontroll dhe monitorim	43
Projekti SCADA/EMS dhe Telekom	43
Pasqyrë e operimit të sistemit elektrik të Kosovës në vitin 2009	45
Bilanci i realizuar 2009 krahasuar me 2008	48
Energjia e pafurnizuar 2007-2009	49
Tregu i energjisë elektrike të Kosovës	51
Madhësia e tregut të energjisë elektrike në Kosovë	52
Bilanci i realizuar i Rrjedhave të Energjisë në rrjetin transmetues për periudhën janar '09 - dhjetor '09	53
Barazimi përfundimtar i palëve në treg	54
Çmimi mesatar i energjisë elektrike dhe importi i energjisë elektrike	55
Transiti i energjisë elektrike	57
Humbjet e energjisë në transmision	57
Reformat në tregun e energjisë elektrike në Kosovë	58
Integrimet rajonale	59
Menaxhimi i burimeve njerëzore	61
Ngjitja e kapaciteteve njerëzore në KOSTT	62
Teknologjia Informative në KOSTT	63
Raportet financiare të audituara	65
Ngjarjet që kanë shënuar vitin 2009	71

Lista e tabelave

Tab. 1	Gjatësitë e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre
Tab. 2	Vjetërsia e linjave
Tab. 3	Kapacitetet transformuese të rrjetit të KOSTT-it për vitin 2009
Tab. 4	Kapacitetet e interkoneksionit për vitin 2009
Tab. 5	Indikatorët kyç të performancës teknike-Operatori i Transmisionit
Tab. 6	Projektet e implementuara në vitin 2009
Tab. 7	Statusi i investimeve kapitale në Sistemin Transmetues të Kosovës për vitin 2009
Tab. 8	Energjia e furnizuar dhe pafurnizuar
Tab. 9	Të dhënat e burimeve njerëzore të KOSTT-it për vitin 2008/2009
Tab. 10	Bilanci i gjendjes 31.12.2009
Tab. 11	Pasqyra e të hyrave
Tab. 12	Pasqyra e ndërrimeve në kapital më 31 dhjetor 2009
Tab. 13	Pasqyra e rrjedhës së parasë, më 31 dhjetor 2009

Lista e figurave

Fig.1	Struktura organizative e KOSTT
Fig.2	Procesi i amendimit të Kodeve Teknike
Fig.3	Struktura e tarifave dhe ngarkesave të KOSTT, të cilat do të zbatohen nga data 1 prill 2009
Fig. 4	Në formë të përgjithshme, numri total i aseteve sipas nivelit të tensionit
Fig. 5	Krahasimi i intervenimeve /2007/2009
Fig. 6	Krahasimi i realizimit të mirëmbajtjes fizike për periudhën 2007/2009
Fig. 7	Krahasimi i rënieve të LP-ve 2008/2009
Fig. 8	Krahasimi i rënieve të AT-ve 2008/2009
Fig.9	Krahasimi i indikatorëve të performancës së OT 2008/2009
Fig. 10	Investimet e planifikuara dhe të realizuara për çdo projekt për vitin 2009
Fig. 11	Zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të transmisionit gjatë vitit 2009
Fig. 12	Humbjet në baza mujore për vitin 2008 dhe 2009
Fig. 13	Energjia e pafurnizuar 2007-2009
Fig. 14	Rrjedhat fizike nëpër rrjetin transmetues të KOSTT për vitin 2009
Fig.15	Profili i konsumit total duke përfshirë edhe humbjet distributive të energjisë elektrike
Fig.16	Konsumi jotarifor dhe konsumi tarifor i KEK-Furnizimit bashkë me humbjet në distribucion në vitin 2009
Fig. 17	Konsumi jotarifor dhe konsumi tarifor bashkë me humbjet në distribucion sipas muajve gjatë vitit 2009
Fig. 18	Bilanci i rrjedhave të energjisë për vitin 2009
Fig. 19	Përfshirja e palëve në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për vitin 2009
Fig. 20	Krahasimi i çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike për vitin 2008 dhe 2009
Fig. 21	Krahasimi i çmimit mesatar të energjisë elektrike për vitin 2008 dhe 2009
Fig. 22	Importi dhe eksporti i energjisë elektrike me shumicë sipas tregtarëve të energjisë elektrike me shumicë
Fig. 23	Transiti i energjisë elektrike në rrjetin horizontal të Kosovës për vitin 2008 dhe 2009
Fig. 24	Pasqyra krahasuese e humbjeve për vitin 2008 dhe 2009
Fig. 25	Aktiva 2008/2009
Fig. 26	Të hyrat
Fig. 27	Shpenzimet 2009

Lista e shkurtesave dhe akronimeve

A	Amper
ATR	Autotransformator
ATSO	OST e Shqipërisë
BE	Bashkimi Europian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BM	Balancing Market/Tregu i Balancuar
CAS	Computerized Accounting System/Sistemi i Kompjuterizuar i Kontabilitetit
CAO IG	Coordinated Auction Office Implementation Group – Grupi Implementues për themelimin e Zyrës rajonale për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve
Ct	Kapaciteti i Transmisionit/Transmission Capacity
EJL	Evropa Juglindore
ECLO	European Commission Liaison Office/Zyra e Ndërlidhëse e Komisionit Europian
EMS	Elektromrezha Serbije / Transmisioni i Serbisë
ENTSO-E	European Network of Transmission System Operators for Electricity/Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
EPS	Elektroprivreda Serbije / Elektroekonomia e Serbisë
ETSO	European Transmission System Operators/Operatorët Evropian të Sistemit të Transmisionit
F	Gjinia femërore
FAT	Factory Acceptance Test/Testi pranues i fabrikës
FIDIC	Fédération Internationale Des Ingénieurs-Conseils/Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve konsultues
GWh	Gigavat orë
HC	Hidrocentral
HVM	High Voltage Metering/Matjet e tensionit të lartë
ISO	International Organization for Standardization/Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
ITC	Inter TSO Compensation / Kompenzimi ndërmjet OST-ve
KE	Komisioni Europian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KL	Kualifikim i lartë
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
KQKO	Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale
KSHE	Kryeshef Ekzekutiv.
kV	Kilovolt
KW	Kilovat
KWh	Kilovat-orë
L	Gjatësia e linjave
LP	Largpërçues
M	Gjinia mashkullore
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MVA	Megavolt-amper
MW	Megavat
NACMPF	Network Access Congestion Management Power Flow(nëngrup për menaxhimin e kongjestioneve)
NP	Ndërmarrje publike

NS	Nënstacion
OPEX	Operational Expenditures/Shpenzimet operative
OPGW	Optical Ground Wire/Lidhjet telekomunikuese të cilat operojnë me sistemin fiber-optik
OS	Operator i Sistemit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator i Tregut
PBX	Pajisjet komutuese për ndërlidhje telefonike
PK	Përgatitje e ulët profesionale
PL	Përgatitje me shkollë të lartë
PLC	Power Line Carrier/Transmetim me frekuenca të larta
PMP	Përgatitje e mesme profesionale
PSP	Përgatitje superiore profesionale
PSS/E	Power System Simulator for Engineering/Simulimi i SEE për inxhinier
PZhST	Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit
PZhT	Plani Zhvillimor i Transmisionit
QD	Qendra Dispeçerike
Q.E.D	Qendra Emergjente Dispeçerike
QPT	Qasje e Palës së Tretë
RG SEE	grup rajonal nën ombrellën e MC (Market Committee)-Komiteti i tregut i ENTSO-E i cili do të merret me çështjet e tregut në EJM
SCADA/EMS	Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System/Mbikqyrja, kontrolli dhe grumbullimi i të dhënave/Sistemi për menaxhim të energjisë
SDH	Synchronous Digital Hierarchy/Hierarkia Digjitale Sinkrone
SEE	Sistemi Elektroenergjetik
SETSO	South-East Europe TSO's/OST-të e Europës juglindore
SKK	Standardet Kosovare të Kontabilitetit
SMM	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor
Sn	Fuqia e përdukshme nominale
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
SSH	Stabilimente shpërndarëse
STM-4	Moduli i transportit sinkron-niveli 4
SHTe	Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike
TAS	Time Attendance System/Sistemi i mbikëqyrjes kohore
TC	Termocentral
TI	Teknologjia Informativë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TL	Tension i lartë
TLF	Transmission Loss Factor / Faktori i humbjeve në Transmision
TSO	Transmission System Operator/Operator i Sistemit të Transmisionit
UCTE	Union for Coordination of Transmission of Electricity/Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike
UCTE OH	UCTE Operational Handbook (përmbledhje e parimeve dhe rregullave që duhet të zbatohen TSO-të e Evropës për operimin e sistemeve elektroenergjetike)
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZNKE	Zyra e Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

Të dhënat themelore për kompaninë

Emri i regjistruar:

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT sh.a

Adresa e regjistruar:

Rr. Iljaz Kodra pn, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Numri i regjistrimit të biznesit:

70325350

Data e themelimit:

1 korrik 2006

Licencat nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë:

Licenca për Operim të Sistemit të Transmisionit

Licenca për Operim të Tregut të Energjisë Elektrike

Pronari i aksioneve:

Republika e Kosovës, implementuar përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

Kryesues i Bordit të Drejtorëve:

Ramadan Paçarada

Kryeshef Ekzekutiv:

Fadil Ismajli



Fjala e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve



Ramadan Paçarada

Bordi i Drejtorëve, i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka për detyrë që, nëpërmjet përcaktimit të politikave afariste dhe udhëzimit strategjik, të ruajë dhe të rrisë vlerën e kompanisë në dobi të aksionarit, në këtë rast Republikës së Kosovës. Në funksion të kësaj detyre parësore ka qenë e drejtuar edhe puna e Bordit.

Gjatë vitit 2009 KOSTT ka shënuar progres shumë të rëndësishëm, si në përmirësimin e shërbimeve të veta në ofrimin e një rrjeti transmetues të besueshëm dhe të kapaciteteve të mjaftueshme transmetuese për klientët e vet, që do të thotë se kapacitetet transmetuese janë rritur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme; kjo gjithashtu është shoqëruar me rritje të nivelit të sigurisë së operimit. Këto përmirësime janë mundë-

suar me realizimin e projekteve të shumta në KOSTT, të cilat janë implementuar me një kontroll të mirëfilltë nga menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve. Kjo dëshmohet me raportin e auditorit të pavarur pa asnjë kualifikim, e që në masë të konsiderueshme afirmon punën e Bordit dhe rrit besimin e aksionarit se KOSTT është në rrugë të mirë.

Dëshiroj të theksoj se Bordi në mbështetje të menaxhmentit profesional të KOSTT do të vazhdojë ta përkrahë atë në implementimin e projekteve madhore në të ardhmen, si dhe në përmbushjen e objektivave për inkuadrim të plotë në strukturat rajonale dhe evropiane të sektorit të transmisionit.

Sinqerisht,

Ramadan Paçarada

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

“Bordi i Drejtorëve së bashku me menaxhmentin pas një pune të përbashkët e duke ju falënderuar punës së palodhshme të punonjësve të KOSTT-it kanë arritur objektivat e parapara me Planin e Biznesit dhe politikat zhvillimore dhe kanë tejkaluar rezultatet e arritura të një viti më parë. [...] është arritur që të zvogëlohen ndërprerjet në Transmision nga 28 në 11, të zvogëlohen humbjet në transmision, të zvogëlohen kostot e mirëmbajtjes dhe të dyfishohet fitimi neto nga ai i vitit 2008.

Të gjitha këto u arritën pas një pune të palodhshme të menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve dhe punonjësve të KOSTT-it me rezultatet e të cilëve Aksionari është krenar dhe inkurajon që viti 2010 të jetë edhe më i frytshëm.”

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Njesia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT



Fadil Ismajli

KOSTT tash e katër vjet po dëshmon një përkushtim të jashtëzakonshëm në përmirësimin e sigurisë, të kualitetit dhe të besueshmërisë së shërbimeve të cilat i ofron për përdoruesit e sistemit elektrik të Kosovës.

Konstatimi i lartpërmendur u referohet rezultateve të arritura pothuajse në të gjitha aktivitetet e që në veçanti prezantohen në këtë raportim

vjetor. Nëse analizohen me kujdes vlerat e prezantuara mund të shihen ndryshime pozitive të performancës që drejtpërdrejt i referohen përkushtimit maksimal të punonjësve dhe

menaxhmentit të KOSTT-it. Këto rezultate janë rrjedhojë e një planifikimi adekuat të burimeve njerëzore, teknike dhe financiare nga vitet e kaluara e që po reflektohen përmes ngritjes së efikasitetit në Operimin e Sistemit dhe të rrjetit të transmissioinit, rritjes së besimit nga ana e institucioneve financiare falë qasjes profesionale në politikën financiare të ndërmarrjes, e dizajnuar për siguri afatgjatë financiare.

Nuk mund të mos theksoj vetëm disa tregues kryesorë që paraqesin të arriturat e sotme në krahasim me vitin 2006, kur KOSTT ka marrë përsipër në mënyrë të mëvetëshme operimin e sistemit:

- kapacitetet e transmissioinit janë rritur për më shumë se 1/3;
- numri i avarive (rënieve) në linjat furnizuese gati është përgjysmuar;
- trendi i zvogëlimit të humbjeve vazhdon,
- vlera e aseteve në këtë periudhë është katërfishuar.

Viti 2009 ishte sfidë nga aspekti i zbatimit të operimit të besueshëm dhe sigurisë së personelit e pajisjes në një anë dhe zbatimit paralel të shumë projekteve kapitale dhe inter-

venimeve të planifikuara të mirëmbajtjes në anën tjetër të cilat lehtë mund të vërehen në raport e që zakonisht përcillen me shkyçje në linja dhe transformator të furnizimit të konsumit të energjisë elektrike.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes për hua me KfW (huaja e parë shtetërore akorduar Republikës së Kosovës – miratuar nga Parlamenti dhe Presidenti) për zhvillimin e infrastrukturës në Kosovë, përkatësisht për ndërtimin e LP 400 kV Kosovë - Shqipëri, kompania KOSTT hap një kapitull të re sa i përket mënyrës së zhvillimit të infrastrukturës së vet të transmissioinit, që dëshmon përkushtimin e KOSTT për një qëndrueshmëri financiare dhe kredibilitet të institucionet financiare ndërkombëtare.

Gjatë viteve të fundit KOSTT me hapa të shpejtë, por të sigurt, ka lëvizur

drejt përmirësimit të Standardeve teknike ndërkombëtare dhe niveli i sigurisë së furnizimit është gjithnjë e më afër këtyre standardeve. Prioritetet në implementim nga Plani-

fikimi i zhvillimit afatgjatë i është dhënë Projekteve që ndërlidhen me përmbushjen e këtyre standardeve, si Standardi (N-1) dhe sigurimi i Shërbimeve ndihmëse kualitative.

Gjatë vitit të kaluar KOSTT ka iniciuar procesin e përgatitjes për anëtarësim në ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity – Rrjeti Evropian për Operatorët e Rrjetit të Transmisionit të Energjisë Elektrike) në të cilën janë shkriur funksionet e UCTE dhe ETSO. Lidhur me këtë janë hartuar një mori procedurash dhe rregullash për operimin e sistemit dhe janë adoptuar ato ekzistuese. Besojmë që gjatë vitit 2010 KOSTT do të arrijë të jetë anëtar i plotë i ENTSO-E, gjë që do të garan-

tonte realizimin e plotë të të drejtave të KOSTT në nivel rajonal dhe evropian.

Tradita e mirë vazhdon edhe sa i përket menaxhimit të burimeve financiare të ndërmarrjes edhe këtë vit, i katërti me radhë, Raporti i auditorit të jashtëm është pa asnjë kualifikim.

Viti 2009 karakterizohet edhe me angazhim shtesë në nivel profesional të KOSTT-it në mbështetje të proceseve paralele në sektorin e energjisë elektrike si Privatizimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit në një anë dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në anën tjetër

Rezultatet dhe arritjet e përmendura kanë ardhur falë angazhimit të pasqorë të të

gjitha strukturave që nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti, ekspertët dhe sidomos punëtorët e KOSTT-it, të cilët vazhdojnë të punojnë me përkushtim të shtuar për arritjen e objektivave të kompanisë dhe janë aseti më i vlefshëm i kësaj ndërmarrjeje.

KOSTT-i i është mirënjohës të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për të gjitha format e përkrahjes dhe kjo mirënjohje më së miri shprehet përmes rezultateve të arritura që edhe ky Raport Vjetor i paraqet.

Fadil Ismajli
Kryeshf Ekzekutiv


“Jam i impresionuar me përkushtimin dhe punën e bërë deri më tash nga drejtori menaxhues dhe personeli i KOSTT-it, me ç’rast i inkurajoj ata të vazhdojnë punën duke përdorur qeverisjen efektive dhe të mirë të korporatës.

Kjo dubet të shërbejë si shembull për ndërmarrjet e tjera publike.

Më erdhi mirë kur mora vesh për investimet e bëra në infrastrukturën e transmisionit të energjisë elektrike, të cilat janë bërë gjatë viteve të kaluara dhe zotohem t’i jap KOSTT-it përkrahjen time gjatë përpjekjeve të tyre për inkudrimin e plotë në shoqatat rajonale dhe evropiane.”

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ICO), Pieter Faith, 22 janar 2010

Sistemi i Transmisionit të Republikës së Kosovës 400/220/110 kV





Raporti i Auditorit të Pavarur

Bordit të Drejtorëve të KOSTT Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu “KOSTT Sh.a.” (Kompania), që përfshijnë pasqyrën e gjendjes financiare më 31 Dhjetor 2009 dhe pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin që ka përfunduar dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të cilat janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi bërë auditimin në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë përputhshmëri me kërkesat etike si dhe planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të arritur siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumata dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontroleve të brendshme të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatjes së politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që neve i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura të ofrojnë bazë për opinionin tonë.

Opinionit

Në opinionin tonë pasqyrat financiare të bashkangjitura prezantojnë realisht, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Kompanisë më 31 Dhjetor 2009, performanca financiare e saj dhe rrjedhjes së parasë po për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar raportin tonë, neve tërheqim vëmendjen në shënimin 21 të këtyre pasqyrave financiare. Një pjesë e statusit të patundshmërive të Kompanisë është ende e pazgjidhur gjerë me datën e këtij raporti.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast kontesti midis këtyre dy raporteve, përparësi ka ai në gjuhën angleze.

Deloitte Kosova sh.p.k.
Prishtinë, Kosovë
13 Maj 2010

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu, a Swiss Verein, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu



KOSTT është operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës

I themeluar me 1 korrik 2006, si rezultat i ristrukturimit të sektorit të energjisë në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, KOSTT sh.a funksionon në bazë të dy licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë:

- Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
- Licenca e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike

KOSTT sh.a është kompani publike pronare e aksioneve të së cilës është Republika e Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

KOSTT është përgjegjëse për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë; sigurimin e qasjes së hapur dhe jodiskriminuese; funksionimin e tregut të ri të energjisë elektrike; sigurimin e kushteve të cilat nxisin konkurrencën në Kosovë; bashkëpunimin me Operatorët e Sistemit të Transmisionit (OST) fqinjë në dobi të Kosovës dhe të rajonit.

Përgjegjësi e KOSTT është që në mënyrë të sigurt dhe të besueshme të transmetojë energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. KOSTT menaxhon rrjetin e transmisionit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, me gjatësi të përgjithshme prej 1077.06 km.





Aktualisht, rrjeti i transmisionit të Kosovës lidhet me shtetet fqinje përmes shtatë linjave ndërkufitare dhe së shpejti do të fillojë ndërtimi edhe i linjës së tetë ndërkufitare. Misioni i KOSTT është që të sigurojë:

- shërbime cilësore, duke implementuar të arriturat tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- transparencë dhe jodiskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian, përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve (burimeve) njerëzore.

Vizioni i KOSTT është që të jetë kompani fitimprurëse për transmetimin e sigurt dhe të qëndrueshëm (stabël) të energjisë elektrike, e përgjegjshme ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropianë.

Objektivat e kompanisë për vitin 2010

- (1) Të sigurojë qëndrueshmërinë financiare
- (2) Të krijojë një organizatë efektive dhe eficiente dhe të arrijë përmirësime të vazhdueshme në produktivitet
- (3) Të mirëmbajë dhe avancojë funksionin e operimit të sistemit
- (4) Të përmirësojë performancat e sistemit të transmisionit
- (5) Të avancojë kapacitetet e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit
- (6) Të sigurojë ndërtimin efektiv të rrjetit të transmisionit
- (7) Të krijojë mundësitë për operim të tregut në përputhje me zhvillimet e pritura të tregut të energjisë elektrike
- (8) Të përmbushë obligimet nga Traktati duke marrë pjesë aktive në zhvillimin dhe operimin e tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal i tregut dhe të kontribuojë në zhvillimin rajonal të tregut)
- (9) Të ndërtojë marrëdhënie efektive me palët e interesit
- (10) Të sigurojë që KOSTT të jetë punëdhënës i mirë dhe atraktiv
- (11) Të sigurojë që KOSTT të jetë një organizatë përgjegjëse nga aspekti mjedisor
- (12) Të krijojë një ambient të sigurt pune

**Të sigurojë
qëndrueshmërinë
financiare**



Qeverisja dhe Organizimi në KOSTT



Foto nga takimi i Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve

Ramadan Paçarada

Kryesues

Fadil Ismajli

Kryeshef Ekzekutiv

Fadil Rrustemaj

Drejtor

Faton Deda

Drejtor

Fatos Ukaj

Drejtor

Lutfi Maxhuni

Drejtor

Nazmi Mikullovc

Drejtor

Menaxhmenti i lartë në KOSTT

Fadil Ismajli

Naim Bejtullahu

Kadri Kadriu

Nebih Haziri

Merita Kostari

Besim Gërxhaliu

Sabri Musiqi

Skender Gjonbalaj

Ilir Shala

Resmije Ahma

Jusuf Imeri

Abdulsatar Ibrahim

Isak Kika

Shpresa Kursani

Kryeshef Ekzekutiv

Zv. Kryeshef Ekzekutiv për Zhvillim

Zv. Kryeshef Ekzekutiv për Operim

Drejtor i Departamentit të Financave

Sekretare e Kompanisë

U.d. Drejtor i Departamentit të Operimit të Transmisionit

Drejtor i Departamentit të Operimit të Sistemit

Drejtor i Departamentit të Tregut

Drejtor i Departamentit për Menaxhim të Projekteve dhe Inxhiniering

Drejtoreshë e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Rregullative

Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Menaxher i Zyrës së Sigurisë

Menaxhere e Zyrës së Planifikimit Strategjik




Fig 1 - Struktura Organizative e KOSTT sh.a

Ligji i ri i Ndërmarrjeve Publike Nr. 03/L-087 i miratuar në qershor të vitit 2008 ka paraparë ndryshimet në qeverisje korporative për Ndërmarrjet Publike (NP) në krahasim me ligjet e mëparshme. Ky ligj ka avancuar aspektin korporativ duke u fokusuar në themelimin dhe rolin adekuat të Bordit të Drejtorëve në NP-të, themelimin e Njësisë së re të monitorimit të NP-ve në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), ka krijuar një qasje transparente që çdo NP duhet të ketë në lidhje me publikimin e dokumenteve, siç parashihet në Ligjin në fjalë, gjë që rrjedhimisht do të rrisë besimin e palës së tretë ndaj punës së këtyre ndërmarrjeve.

Ligji i NP-ve ka parashikuar që KOSTT-i edhe më tutje do të udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve (Bordi) i zgjedhur në pajtim me Nenin 15.1 të Ligjit. Themelimi i Bordit të Ri të Drejtorëve të KOSTT-it dhe të Komisionit të Auditimit, si dhe të Njësisë për monitorimin e NP-ve dhe funksionalizimi i tyre, kanë qenë hapat e parë që Qeveria i ka ndërmarrë në implementimin e ligjit në fjalë. KOSTT ka ndërmarrë të

gjitha aktivitetet e nevojshme për implementimin e ligjit dhe udhëzimeve të lëshuara nga Njësia për monitorimin e NP-ve. Që të reflektohen ndryshimet në qeverisje dhe pronësinë e Qeverisë së Kosovës në asetet e KOSTT-it dhe të ndërmarrjeve të tjera publike, në pajtim me ligjin dhe Vendimin e Komisionit të Ministrave Nr.218/1, të datës 30.09.2009, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka miratuar Statutin e modifikuar dhe Kodin e Etikës dhe të Qeverisjes Korporative bazuar në format e dërguara nga MEF-i. Bazuar në këtë, KOSTT-i ka kryer regjistrimin e modifikimeve në Regjistrin e Biznesit dhe është Certifikuar.

KOSTT-i me vendim të Bordit ka rregulluar punën e vetë Bordit dhe të Komisioneve të KOSTT-it, politikat për kompensim të niveleve të ndryshme në hierarki (bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike), operimin nëpërmjet një Manuali, çështjet disiplinore, të autorizimeve, të planit të pro-kurimit etj.

Bordi ka miratuar planet strategjike dhe zhvillimore të

propozuar nga KOSTT-i, pasqyrat financiare dhe planin e biznesit, raportet vjetore dhe tremujore siç kërkohet nga Ligji për NP. Bordi ka përzgjedhur zyrtarët e Kompanisë (Kryeshefin Ekzekutiv, Sekretarin e Kompanisë, Zyrtarin Financiar), si dhe Auditorin e Brendshëm të KOSTT-it, i cili është përzgjedhur nga Komisioni i Auditimit, në pajtim me kërkesat nga neni 15 i Ligjit të NP.

Gjatë vitit 2009, KOSTT gjithashtu është fokusuar në zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor ("SMM") i cili zhvillohet nëpërmjet praktikave dhe kontrollit të përgjithshëm, e i cili është në përputhje me Standardin ISO 14001.

Bazuar në këtë, KOSTT ka përgatitur Politikat dhe një Manual të cilët mbështesin zhvillimin e mirëfilltë të SMM, me theks të posaçëm në arkitekturën dhe procedurat që kërkohen me synim të përmirësimit gradual "hap pas hapi" të performancës mjedisore. Stafi i KOSTT-it është duke u njohur me aspektet obliguese mjedisore, siç është VNM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) dhe planifikohet trajnimi dhe edukimi i tij në këtë aspekt të rëndësishëm.



Roli i Komisionit të Auditimit

“ Ligji i NP-ve gjithashtu ka themeluar Komisionin e Auditimit i cili përbëhet nga tre (3) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit i vlerëson të gjitha dokumentet që i dorëzohen Bordit të Drejtorëve dhe ia jep rekomandimin e vet Bordit. Komisioni vepron si organ këshillëdhënës i Bordit të Drejtorëve.

Komisioni i Auditimit

Fadil Rrustemaj
Fatos Ukaj
Ramadan Paçarada



Korniza ligjore dhe rregullative

KOSTT është themeluar bazuar në kërkesat e nenit 12.1 (si Operator Transmisioni dhe Sistemi) dhe 27.1 (si Operator Tregu) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike në përputhje me Nenin 8 të Direktivës 2003/54/BE.

KOSTT vepron bazuar në Ligjin e Energjisë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë, aktet nënligjore të Zyrës së Rregullatorit

të Energjisë (“ZRRE”) dhe në pajtim me licencat e lëshuara nga ZRRE për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe për Operator të Tregut të energjisë elektrike.

KOSTT gjithashtu vepron bazuar në Kodet teknike që i nënshtrohen miratimit nga ZRRE, Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera. KOSTT, në bazë të obligimeve licencore ka përpiluar Kodet Teknike (të rjetit, të matjeve etj.), Rregullat e Tregut (modeli bilateral), Bilancet Vjetore Elektroenergjetike dhe Bi-

lancin 10-vjeçar Elektroenergjetik, Planin e Biznesit 2007-2012, Metodologjinë e Tarifave për lidhje në Sistemin e Transmisionit, Procedurat Operacionale dhe Marrëveshjet Komerciale, Standardet për Sigurinë e Sistemit të Transmisionit dhe Planifikim dhe Standardet për Operim, Planin Zhvillimor të Sistemit të Transmisionit (PZhST) për periudhën 2007–2013. Këto janë miratuar nga ZRRE dhe implementohen nga KOSTT-i.

Korniza rregullative

Korniza rregullative për të cilën është përgjegjëse KOSTT është hartuar në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin primar dhe sekondar të Republikës së Kosovës, në pajtim me praktikat më të mira të BE-së duke përcaktuar në mënyrë të qartë veprimet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Rrjetit të Transmisionit dhe Tregut, me një përkushtim që të sigurojnë zhvillimin dhe operimin e sigurt të sistemit të transmisionit dhe tregut.

Amendimet e Kodeve Teknike

Në përputhje me Nenin 26.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i ZRrE-së ka miratuar Procedurën për Menaxhim të Kodeve Teknike dhe Operacionale, siç është përcaktuar në Nenin 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale (KQKO) - nën-kupton komisionin e themeluar për të shqyrtuar dhe për të diskutuar zbatimin, ndryshimet/ modifikimet e Kodeve Teknike dhe Operacionale në Industrinë e Energjisë Elektrike në Kosovë.

Implementimi i dispozitave të Kodeve Teknike nënkupton zbatimin e procedurave operative dhe dispozitave që rregullojnë bashkëveprimin ndërmjet OST dhe OT dhe përdoruesve të sistemit të transmisionit.



“ Inicimi i procesit të amendimit të dispozitave të Kodeve Teknike (Kodi i Rrjetit, Kodi i Shpërndarjes, Kod i Matjes, Kodi i Matjes së OSSH, Kodet e Pajisjeve Elektrike, Kodet e Standardeve Elektrike, Kodi për Mbrojtjen e Konsumatorëve) është bërë sipas procedurës së përcaktuar në dokumentin Procedura për Menaxhimin e Kodeve Teknike/Operacionale.

Ky është një proces që inicohet nga një Anëtar i KQKO-së me kërkesë për shqyrtim të mëtutjeshëm nga KQKO (Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale) i cili shqyrton kërkesën dhe arsyeshmërinë dhe me pajtim të anëtarëve e procedon atë për miratim në ZRrE.




Fig. 2. Procesi i amendimit të Kodeve Teknike

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2009, KOSTT ka shqyrtuar në vazhdimësi implementimin e Kodeve Teknike dhe Operacionale, si dhe zbatimin e dispozitave të tyre në dokumentet e tjera relevante, dhe në ndërlidhje me këtë ka bërë disa kërkesa drejtuar KQKO-së për amendim të dispozitave të Kodeve Teknike. Në bazë të kërkesës së paraqitur nga KOSTT, KQKO ka shqyrtuar propozimet për amendim për dispozita të caktuara në Kodin e Pajisjeve Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Matjeve dhe ka dërguar kërkesën në ZRrE për miratim. Gjatë kësaj periudhe ZRrE me kërkesë të KQKO-së ka miratuar (Vendimi V_163_2009) kërkesën për amendimin e neneve 3.2 dhe 17.4.2.2 të Kodit të Pajisjeve Elektrike.

Plani Zhvillimor i Transmisionit – është dokument i cili hartohet nga KOSTT në bazë të kërkesave të legjislacionit primar dhe sekondar. Ky dokument përgatitet nga Operatori i Sistemit dhe pas miratimit nga ZRrE publikohet në faqen elektronike të KOSTT. Me Kodin e Rrjetit është e rregulluar që KOSTT çdo vit të lëshojë në qarkullim një Plan Zhvillimor të Transmisionit të detajuar për 7 vjetët e ardhshëm.



“ Në harmoni me kërkesat që dalin nga ENTSO/E, dokumenti i rishikuar Plani Zhvillimor i Transmisionit, tani ndryshe nga dokumenti i parë PZhT (2007-2013), do të mbulojë periudhën 10-vjeçare (2010 – 2019)

me ç’rast viti 2009 paraqet vit referent apo i ashtuquajtur viti zero. Në përpilimin e këtij dokumenti janë marrë në konsiderim të gjitha informatat, si: detajet e projekteve, data e pritur e vënies në operim të projektit, aplikacionet për lidhje (kyçje) në rrjetin e transmisionit që kanë ndodhur gjatë çerekut të parë dhe të dytë të vitit 2009. Për përgatitjen e planit zhvillimor janë bërë llogaritjet e duhura me softuerin përkatës PSS/E v. 32, duke simuluar modelet kompjuterike të sistemit bazuar në të dhënat e siguruara nga KOSTT dhe nga përdoruesit e rrjetit, po ashtu bazuar edhe në të parashikimet e ngarkesës. Të dhënat e gjenerimit janë siguruar nga KEK-Gjenerimi dhe nga gjeneruesit e tjerë. Të dhënat relevante në lidhje me kapacitetet e reja gjeneruese (hidrocentralet e vogla) janë marrë nga MEM. Të dhënat për interkonjektorët që pritet të ndërtohen në rajon janë siguruar nga studimet që bëhen në Grupin Projektues për Planifikimin e Rrjetit Rajonal të Transmisionit - SECI, në të cilin grup kontribuon edhe KOSTT-i nëpërmjet përfaqësuesit të vet.

E veçantë tjetër është se në këtë Plan Zhvillimor është marrë parasysh edhe energjia nga era. Në Kosovë qysh nga fillimi i vitit 2009 për lidhje në rrjetin elektrik kanë aplikuar disa investitorë të jashtëm të cilët kanë planifikuar kapacitetin total prej 157 MW. Deri më tash në KOSTT janë paraqitur dy aplikacione për lidhjen e turbinave me erë në rrjetin elektrik:

- projekti i Shtimes me kapacitet prej 127 MW, pjesa juglindore e Kosovës, dhe
- projekti Kitka me kapacitet prej 30 MW, pjesa lindore e Kosovës.

Aktualisht në Kosovë nuk ekziston harta e vlerësimit të potencialeve të erës, ndërsa investitorët me iniciativën e tyre kanë bërë matjen e shpejtësisë së erës në zonat e caktuara. Projektet zhvillimore të rrjetit të transmisionit janë ndarë në pesë kategori:

- Përforcimet në rrjetin e Transmisionit
- Lidhjet (kyçjet) e reja të ngarkesës shpërndarëse
- Rivitalizimi i rrjetit të transmisionit
- Lidhjet (kyçjet) e reja të gjeneratorëve.
- Projektet përkrahëse të Sistemit të Transmisionit (menaxhim, monitorim, matje dhe kontroll)

Zhvillimi i sistemit tarifor të transmisionit

Sistemi Tarifor i Transmisionit është ndërtuar dhe vazhdon të zhvillohet në bazë të legjislacionit përkatës si:

- 1) **Legjislacioni Primar**, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës:
 - a) Ligji mbi Energjinë; b) Ligji mbi Energjinë Elektrike; c) Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe
 - 2) **Legjislacioni Sekondar**, i miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji:
 - a) Metodologjia e Tarifave; b) Rregulla e Çmimeve; c) Udhëzimet për Aplikim për Tarifa; d) Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit.
- Që nga themelimi i KOSTT-it

në vitin 2006 janë zhvilluar katër procese të Shqyrtimit të Çmimeve të Energjisë Elektrike; fillimisht janë vendosur Të Hyrat e Lejuara Trevjeçare, e më pas çdo vit janë bërë Shqyrtimet e Çmimeve: SHTE 1 – Vendosja e Tarifave 2007 – 2008; SHTE 2 – Vendosja e Tarifave 2008 – 2009; SHTE 3 – Vendosja e Tarifave 2009 – 2010 dhe SHTE 4 2010 – 2011.

Metodologjia e Tarifave të Energjisë Elektrike mbulon përcaktimin e të ardhurave totale të lejuara që mund të fitohen prej tarifave të rregulluara dhe parimeve që qeverisin strukturën e tarifave të përdorura për mbu-

limin e këtyre të ardhurave vjetore.

Tarifat e Transmisionit të Energjisë Elektrike janë tarifa që reflektojnë kostot e nevojshme për funksionimin dhe operimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë.

Zyra e Rregullatorit për Energji me vendimin nr. V_172_2009, të datës 15.04.2009 ka miratuar Tarifat dhe Ngarkesat e Transmisionit, të cilat zbatohen nga KOSTT nga data 01.04.2009.

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Aprovuar
Gjenerimi	400kV / 220 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	110 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.328
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	400kV / 220 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.636
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	110 kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	10.094
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020

Fig.3 Struktura e Tarifave dhe Ngarkesave të KOSTT, nga data 1 prill 2009



Marrëdhëniet efektive me palët e treta dhe transparenca

Për vendosje të marrëdhënieve efektive me palët e interesit, KOSTT në mënyrë permanente bën implementimin e Strategjisë së Komunikimit dhe të Politikave për Çështje Rregullative, të mbështetura me Procedurat për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm. Zhvillimi i proceseve të rregullta të komunikimit paraqet element thelbësor për rritjen e performancës së kompanisë dhe si të tilla trajtohen me një vëmendje të veçantë nga punonjësit e KOSTT-it, me qëllim të arritjes së objektivave të kompanisë dhe zhvillimit të transparencës, si një ndër fushat kryesore të zhvillimit të mirëfilltë të komunikimit me palët e interesit.

KOSTT në mënyrë permanente punon në drejtim të avancimit të marrëdhënieve të komunikimit me palët e interesit. Komunikime të rregullta dhe të vazhdueshme realizohen me organin e pavarur rregullativ, Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRë), me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (MEM), Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe me të gjitha palët e përfshira në Sistemin e Transmisionit. Komunikimet me palët e interesit përqendrohen në implementimin e detyrimeve që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar që në vete përfshijnë disa procese të ndryshme: raportimin, informimin, shqyrtimin, miratimin, publikimin, si dhe një proces të veçantë, atë të monitorimit për implementimin e dispozitave nga legjislacioni primar dhe sekondar. Duke marrë parasysh se mediat janë transmetues të

mesazheve si dhe element esencial i dialogut të hapur, për qëllime të informimit/ mirëmbajtjes së marrëdhënieve. Të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2009, projektet e shumta kapitale që janë implementuar apo kanë filluar implementimin, para palëve të interesit janë prezentuar përmes formave të definuara me **Strategjia e Komunikimit** Gjatë vitit 2009 është evidente avansimi i marrëdhënieve me mediat, gatishmëria për transparencë dhe përgjigje pozitive dhe në kohë në kërkesat e mediave. Interesimi i medias së shkruar për transmetimin e aktiviteteve dhe zhvillimeve në KOSTT është rritur prej vitit 2008 në vitin 2009 për 60 %.

Zhvillimit të mirëfilltë të marrëdhënieve me palët e interesit paraprin avansimi i transparencës, si një ndër kriteret kryesore për zhvillimin e kësaj



fushe. Qasja transparente dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmisionit nga palët të cilat nuk janë pronare të infrastrukturës së rrjetit, njihet si Qasje e Palës së Tretë (QPT), e që është themelore për lehtësimin e një konkurrence më të madhe, gjë që ndihmon që tregu i energjisë të funksionojë në mënyre efektive.

“KOSTT ka hartuar dokumentet dhe procedurat përkatëse përmes së cilave trajtohen pa dallim palët e interesit dhe palët të cilat janë të lidhura në rrjetin e transmisionit.

Hartimi i Metodologjisë së Tarifave të Lidhjes (Kycjes) në Rrjetin e Transmisionit i ka

hapur rrugë zhvillimit të rrjetit dhe transparencës, e në lidhje me këtë edhe detyrimeve nga Kodet Teknike. KOSTT është në fazën finale të nënshkrimit të Marrëveshjeve për Lidhjen në Rrjetin e Transmisionit me të gjitha palët e lidhura në Rrjetin e Transmisionit (KEK Gjenerimin, KEK Shpërndarjen, N. H. “Ibër Lepenci”, Feronikel, SharrCem etj.), përderisa në anën tjetër ka krijuar marrëdhënie të shkëlqyera me operatorët fqinjë duke nënshkruar më 30 janar 2009 Marrëveshjen Ndërmjet OST-ve me Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë (AOST), dhe duke krijuar marrëdhënie bashkë-punimi me atë të Malit të Zi dhe Maqedonisë.



Pasqyrë e Operimit të Rrjetit të Transmisionit të Kosovës

Mirëmbajtja 2009

KOSTT në bazë të licencës që posedon, është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrjetit të transmisionit. Sistemi i Transmisionit përfshin të gjitha linjat në nivelin e tensionit 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, si dhe të gjitha nënstacionet me nivel tensioni 400/220 kV, 400/110 kV, dhe 220/110 kV, si dhe stabilimentet e tensionit të lartë 110 kV në nënstacionet 110/x kV.

Kapacitetet transmetuese të aseteve të KOSTT-it janë si më poshtë:

Kapacitetet aktuale të linjave të rrjetit të transmisionit në njësi të gjatësisë bazuar në fundin e vitit 2009 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Linjat ajrore 2009	Gjatësia totale në Kosovë [km]	Kapaciteti transmetues $C_t = S_n \cdot L$ [MVA km]
400 kV	181.815	239450.355
220 kV	231.882	77433.744
110 kV	663.3585	66730.8185

Tab.1 Gjatësitë e linjave transmetuese dhe kapaciteti transmetues i tyre

Në tabelën 2 në vijim është paraqitur vjetërsia e linjave sipas nivelit të tensionit

#	Mosha (vjet)	Niveli 400 kV	Niveli 220 kV	Niveli 110 kV
1	0-25	40.54 %	48.80 %	33.11 %
2	25-35	59.45 %	1.90 %	21.61 %
3	35-50	0 %	49.20 %	45.27 %

Tab 2. Vjetërsia e linjave

Kapacitetet aktuale transformuese të rrjetit të Transmisionit të cilat menaxhohen nga KOSTT-i janë të përqëndruara në nënstacionet 400/220 kV dhe 220/110 kV. Në tabelën 3 janë paraqitur kapacitetet transformuese për vitin 2009.

Autotransformatorët	Numri i autotransformatorëve	Kapaciteti total (MVA)
400/220/110 kV	4	Total 1500 MVA
NS Kosova B 400/220 kV	3	3x400 = 1200 MVA
NS Peja 3 400/110 kV	1	1x300 = 300 MVA
220/110 kV	7	Total 7x150 = 1050 MVA
NS Kosova A	3	3x150 = 450 MVA
NS Prishtina 4	2	2x150 = 300 MVA
NS Prizreni 2	2	2x150 = 300 MVA

Tab 3. Kapacitetet transformuese të rrjetit të KOSTT-it për vitin 2009

Kapaciteti i interkoneksionit për vitin 2009 është paraqitur në tabelën në vijim:


Linja	Tensioni (kV)	Fuqia natyrore (MVA)	NTC Sn (MVA)
LP 407 NS Kosova B - NS Nish	400	500	450 1316
LP 420 NS Kosova B – NS Ribare	400	500	400 1316
LP 420 NS Kosova B - NS Shkupi 5	400	500	400 1316
LP 2303 NS Prizreni 2 - NS Fierza	220	120	100 297
LP 205/2 NS Podujeva - NS Krush	220	120	100 297

Tab. 4 Kapacitetet e interkoneksionit për vitin 2009

Të gjitha këto asete përbëjnë një tërësi funksionale dhe komplekse që mundëson funksionimin e sistemit Transmetues të Kosovës.



Në fig. 4 është paraqitur në formë të përbledhur numri i elementeve të rrjetit të transmisionit sipas nivelit të tensionit.



Sasia e autotransformatorëve është paraqitur sipas tensionit primar.

Plani i mirëmbajtjes është i bazuar në buxhetin e OPEX-it, të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, objektivat e të cilit janë:

- Mirëmbajtja e të gjitha pajisjeve të rrjetit transmetues, përfshirë linjat dhe të gjitha pajisjet në NS.
- Rivitalizimi i pajisjeve të nevojshme si masë preventive.

Përmes këtyre objektivave, synimi kryesor është që të arrihen këto performanca:

- Rritja e sigurisë dhe e besueshmërisë së operimit të stabilimenteve
- Ngritja e kapaciteteve ekzistuese të Transmisionit aty ku kjo paraqitet si mundësi.

Në kuadër të këtij buxheti janë zhvilluar projektet në këto pajisje:

- Ndërimi i përçuesve të linjave 220 kV dhe përforcimi i shtyllave ekzistuese me gjatësi $L = 17.5$ km
- Ndërimi i fushave të stabilimenteve 220 kV, 5 fusha komplet
- Ndërimi i fushave 110 kV, 7 fusha
- Ndërimi i transformatorëve matës të rrymës 110 kV, 220 kV, 400 kV, 33 copë
- Ndërimi i transformatorëve matës të tensionit 110 kV, 10 copë
- Ndërimi i shkarkuesve të mbitensionit, 110 kV, 220 kV, 6 copë
- Ndërimi i mbrojtjeve rele, 110kV, 6 copë
- Ndërimi i izolatorëve nga porcelani në polimer në tri linja me gjatësi ajrore prej 63.45 km,
- Ndërimi i izolatorëve të zbarrave në anën 220 kV në NS Kosova B, 5000 copë



Realizimi i planit të Opex-it i paraparë për vitin 2008 i cili ka vazhduar në vitin 2009 kap vlerën prej 3,596,758.6 EUR


Ndërkaq vlera e realizimit të planit të Opex-it për vitin 2009 është **1,291,825.4 EUR**

Krahas zhvillimit të projekteve është finalizuar përpilimi i politikave për mirëmbajtje preventive e cila është miratuar nga Bordi i Drejtorëve.




Revitalizimi i rrjetit transmetues dhe mirëmbajtja preventive përveç rritjes së kapacitetit transmetues ka ndikuar edhe në rritjen e besueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit, çka rezulton me numër më të vogël të rënieve dhe intervenimeve në pajisjet në nënstacione dhe linja.


Trendi i zvogëlimit të intervenimeve si rezultat i mirëmbajtjes preventive dhe zbatimit të teknologjisë moderne mund të shihet në grafikun e mëposhtëm.



Në Fig. 6 është paraqitur realizimi i planifikimit të mirëmbajtjes, nga shihet se është arritur një përqindje mjaft e lartë e realizimit duke pasur parasysh vështirësitë e realizimit të shkyçjeve për shkak të mosplotësit të kriterit n-1 (energjisë së padërguar), apo si rezultat i realizimit të një numri të madh të projekteve njëkohësisht.




Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur krahasimi i rënieve të LP për dy vjetët e fundit, na shihet se numri i rënieve për vitin 2009 është dukshëm më i vogël se vitin e mëparshëm, si rezultat i përkushtimit në punë dhe investimeve të qëlluara.





Në përgjithësi edhe numri i rënieve të autotransformatorëve është më i vogël krahasuar me vitet e mëparshme, si rezultat i aktiviteteve dhe rivitalizimit të pajisjeve.



Pasqyrën e të arriturave në rrjetin e transmisionit në vitin 2009 mund ta paraqesim edhe përmes indikatorëve të performancës. Nga grafiku mund të shihet se të gjithë indikatorët, si numri i prishjeve në linja dhe nënstatione, duke përfshirë edhe mbrojtjet rele, pastaj koha mesatare e riparimit të këtyre prishjeve si dhe energjia e padërguar për shkak të mirëmbajtjes së këtyre stabilimenteve për këtë vit janë tregues shumë më pozitivë krahasuar me vitin e mëparshëm.

Indikatorët kyç të performancës teknike-Operatori i Transmisionit**


Indikator	Niveli i tensionit	2008	2009	2009/2008 (%)
	kV	Janar dhjetor 2008	Janar dhjetor 2009	%
T1 Numri i prishjeve në linja në 100 km gjatësi	400	1.10	0.00	0.00
	220	0.86	0.43	50.00
	110	4.33	1.89	43.65
T2 Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë (në orë)	400	1.86	0.00	0.00
	220	2.59	0.63	24.15
	110	4.32	3.55	82.18
T3 Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (në minuta)	400	0.00	0.00	0/0
	220	0.00	0.00	0/0
	110	0.56	0.10	18.15
T4 Numri i prishjeve në transformator në 100 transformatorë (në njësi)	400/220 (110)	0.00	0.00	0/0
	220/110	40.00	11.10	27.75
T5 Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator (orë)	400/220 (110)	0.00	0.00	0/0
	220/110	2.80	0.08	2.68
T6 Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (në minuta)	400/220 (110)	0.00	1.60	0/0
	220/110	0.00	1.00	0/0

Tab 5. Indikatorët kyç të performancës teknike-operatori i transmisionit

Indikatorit		Niveli i tensionit	2008	2009	2009/2008 (%)
		kV	Janar dhjetor 2008	Janar dhjetor 2009	%
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	40.00	0.00	0.00
		220	45.10	13.26	29.40
		110	40.04	5.39	13.46
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (në orë)	400	11.00	0.00	0.00
		220	14.20	1.33	9.33
		110	12.80	0.81	6.35
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit/fushës (në minuta)	400	0.00	0.00	0/0
		220	0.00	0.00	0/0
		110	0.35	2.40	681.82
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	20.00	0.00	0.00
		220	12.30	2.77	22.52
		110	1.40	5.70	407.14
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (në orë)	400	5.35	0.00	0.00
		220	8.50	0.33	3.82
		110	4.50	0.80	17.78
T12	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit në minuta)	400	0.00	0.00	0/0
		220	0.00	0.00	0/0
		110	0.00	0.00	0/0

Tab 5. Indikatorët kyç të performancës teknike-operatori i transmisionit

** Logaritja e indikatorëve teknikë është bërë sipas dokumentit Indikatorët e Performancës Teknike, të miratuar nga ZRRRE të cilës edhe i raportohen






Zhvillimi dhe avancimi i Rrjetit të transmisionit të Sistemit Elektrik të Kosovës

Investimet në infrastrukturën e Sistemit Transmetues luajnë rol vendimtar në mbarëvajtjen e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Në këtë drejtim KOSTT gjatë vitit 2009 ka bërë çmos që projektet e rëndësishme të veçantë të implementohen në mënyrë kualitative dhe në kohë. Projektet më të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e Sistemit Transmetues të Kosovës dhe në përgjegjësi të SEE të Kosovës janë:

- Ndërtimi i NS 400/110/10.5 kV – Peja 3 (ATR 300 MVA) bashkë me linjat ndërlidhëse 400 kV dhe 110 kV (NS Peja 3 – NS Peja 1, NS Peja 3 – NS Istog, NS Peja 3 – NS Vallaq/Skenderaj),
- Rindërtimi i Linjës 110 kV, nr. 212, NS Kosova A – NS Bibaj
- Instalimi i ATR1, 150 MVA në NS 220/110 kV – Kosova A
- Rindërtimi i Linjës 110 kV, NS Gjakova 1 – Deçan

Të gjitha këto projekte investuese kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve transmetuese e më këtë eliminimin e fyteve të ngushta në rrjetin transmetues, zvogëlimin e humbjeve, përmirësimin e profilit të tensionit dhe furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike më kualitative, që çon në krijimin e kushteve për zhvillim të përgjithshëm të ekonomisë dhe të industrisë në vendin tonë.

Kapaciteti i Transmisionit nga 930 MW, sa ishte në vitin 2007, në fund të vitit 2009 arriti vlerën 1250 MW, një rritje kjo jashtëzakonisht pozitive, duke e sjellë Operimin e Sistemit Transmetues nga një gjendje kritike në një gjendje të konsoliduar. Procesi zhvillimor në rrjetin e Transmisionit do të vazhdojë me intensitet të theksuar edhe në vitet në vijim, bazuar në Planin Afatgjatë Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit, në të cilin janë identifikuar nevojat për përfundime të mëtutjeshme, ashtu që Sistemi i Transmisionit të mund të ndjekë rritjen e konsumit e të gjenerimit, gjithmonë duke plotësuar kriteret teknike, në pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit.



Zhvillimi i Rrjetit Transmetues

Projektet në rrjetin e Transmisionit (2009)

Pas themelimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) janë zhvilluar aktivitete të theksuara në zhvillimin e Rrjetit të Transmisionit. Gjatë këtij procesi është përpiluar Plani Zhvillimor dhe Investiv 2007-2013, i cili më 23 korrik 2009 është miratuar nga ZRrE. Duke u bazuar në aktivitetet të cilat janë duke u zhvilluar në KOSTT në lidhje me zhvillimin e projekteve të planifikuara nga Plani Zhvillimor, në vazhdim është paraqitur tabela e cila përfshin listën e projekteve të cilat kanë përfunduar në 2009 dhe të cilat janë në përfundim dhe ato të cilat me siguri të plotë pritet të kryhen deri në fund të vitit 2010.

Emërtimi	Karakteristikat
PROJEKTI PEJA 3 -ATR1 400/110kV -Kuçje në linjën interkonjektive L437 -Linja e re 110 kV Peja 3 - Klina -Ndërrim përcuesi i L126/4 -Kuçje e NS Skenderaj në L163 Ndërrim përcuesi i linjës Skenderaj - Peja 3	Autotransformator 300MVA Linjë dyfishe 2 x 490 mm ² , ASCR, 0.6 km Linjë 110 kV, ASCR 240 mm ² , 18km "Hot Wire" 150 mm ² , 23 km Linjë dyfishe 110 kV, 240 mm ² , 5 km "Hot Wire" 150 mm ² , 17.9 km
Adaptimi i linjës L212 si linjë 110kV NS Kosova A - NS Bibaj	Riparimi i linjës me parametra të mëparshëm nga NS Kosova A deri në NS Bibaj, 31 km
Instalimi i AT1 - 150 MVA në NS Kosova A	Autotransformatori 150 MVA, 220/110kV zëvendëson autotransformatorin AT1-100 MVA
Ndërrim përcuesi në linjën 110 kV, nr 126/1, NS Deçan – NS Gjakova 1	Ndërrimi i përcuesit nga 150 mm ² në 240 mm ² , 20.2 km
NS Rahoveci 110/35/10(20) Linja 110kV NS Prizren 2 - NS Rahoveci	Linja 110 kV, 240 mm ² , 17.241 km

Tab. 6 Projektet e implementuara në vitin 2009

Të katër projektet e paraqitura në tabelën 6 janë jashtëzakonisht të rëndësishme për rritjen e besueshmërisë dhe të sigurisë së Operimit të Sistemit Transmetues. Ato drejtpërdrejt kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve transmetuese të Sistemit. Projekti i pestë paraqet përkrahje të konsumit - shpërndarjes për rajonin e Rahovecit.



“Paketë-projekti Peja 3 paraqet përforcimin më të madh të rrjetit të transmissio­nit që nga vitet ‘80.

Ky projekt i karakterizuar me përfitim shumë të madh, ka ndikuar në rritje të kapacitetit

transmetues, në reduktimin e humbjeve në rrjet, në shkakimin e një numri të konsiderueshëm të linjave 110 kV, si dhe të autotransformatorëve në NS Kosova A dhe NS Prizreni 2.

Gjithashtu edhe projekti i përfunduar Adaptimi i linjës 220 kV (L212) si linjë 110 kV dhe lidhja/kuçja e saj në NS Bibaj paraqet projekt tejet të rëndësishëm për rrjetin

e transmissio­nit. Efektet e këtij projekti kanë mundësuar eliminimin e fytëve të ngushta të linjës 110 kV

furnizuese që lidh NS Prishtina 4 – NS Bibaj, rritjen e kualitetit të furnizimit të pikave të shpërn-

darjes: Bibaj (Ferizaj, Viti, Therandë dhe Sharr).

Instalimi i autotransformatorit të ri AT1 - 150 MVA në NS Kosova A paraqet projekt të koordinuar me projektin e linjës L212. Instalimi i këtij transformatori ka eliminuar fythin e ngushtë në transformim dhe ka mundësuar optimizmin e punës së Sistemit Transmetues në aspektin e rrjedhave të fuqisë aktive dhe reaktive.

Gjithashtu edhe projekti i ndërrimit të përcuesit 150 mm² të linjës që lidh NS Gjakova 1 – NS Deçan me përcues 240 mm², i cili ka përfunduar në shtator 2009, ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve transmetuese të rrjetit, si dhe në përmirësimin e sigurisë së sistemit transmetues.

#	Projekti	Burimi i financimit	Vlera e Kontrates	Buxheti i Planifikuar 2009 BKK	Buxheti i Realizuar 2009	Viti Planifikuar Përfundimit
1	Shërbimi konsulent për projekt dhe Paket Projekti NS 400/110 kV – Peja 3 (Kon+ KfW+BKK+Kon)	KfW/BKK	24.216.233	7.442.000	7.210.000	2010
2	Shërbimi konsulent për projekt dhe Rehabilitimi i NS Kosova A (kon+BKK)	BKK	10.334.070	1.305.948	208.641	2010
3	Shërbimi konsulent për projekt & SCADA/EMS & Telekom (Lot1+Lot2+Kon)	BKK	17.981.680	5.500.000	5.606.877	2011
4	Instalimi i TR te ri 150MVA ne NS KOS A	BKK	2.845.000	2.838.460	2.560.482	2009
5	Instalimi i TR te ri 150MVA ne NS PR 4	KOSTT	2.989.350	1.500.000	1.333.980	2010
6	ITSMO-Njehsoret	BKK	2.071.783	532.239	548.412	2009
7	Shërbimi konsulent për projekt dhe Paket Projekti NS 400/110 kV – Ferizaji 2	ECLO/BKK	20.429.500	6.623.353	4.983.853	2012
8	Shërbimi konsulent për linjen 400 kV Kosovë-Shqipëri	KfW/BKK	1.154.620	320.000	51.300	2013
	TOTALI			26.062.000	22.503.545	

Tab 7. Statusi i Investimeve Kapitale në Sistemin Transmetues të Kosovës për 2009





Fig 10. Investimet e planifikuara dhe të realizuara për çdo projekt për vitin 2009

Zhvillimet në kapacitetet gjeneruese

Gjatë vitit 2009 në KOSTT janë dorëzuar 6 aplikacione për kyçje të gjeneratorëve (me erë dhe një me ujë). Në pajtim me Metodologjinë e tarifave për kyçje në Rrjetin Transmetues, KOSTT ka përgatitur ofertat përkatëse për secilin aplikues. Gjatë vitit 2009 nuk ka pasur ndonjë zhvillim në aspekt të ngritjes së kapaciteteve gjeneruese që kanë ndikuar në sistemin transmetues.

Zhvillimi i interkoneksionit me vendet fqinje

Një ndër projektet kapitale më të rëndësishme në Sistemin Transmetues të Kosovës padyshim është Projekti i Ndërtimit të Linjës 400 kV, Kosovë – Shqipëri. Ky projekt është paraqitur si nevojë e menjëhershme në përmbushjen e nevojave në rritje në rajon për energji elektrike dhe në eliminimin e kufizimeve në rrjetin transmetues interkonektiv rajonal.

Projekti do të financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW); 50 % do të jetë donacion dhe 50 % në formë të kredisë së butë. Kushtet e kredisë për projektin në fjalë do të jenë për 12 vjet, me 3 vjet periudhë "grejs", dhe me shkallë të volitshme interesi. Në 2009 është bërë nënshkrimi i kontratës për shërbime konsulentësh për Linjën 400 kV, Kosovë – Shqipëri.

Faza e parë për pjesën e linjës (përgatitja e dokumentacionit për tender), që kalon nëpër Kosovë kap shumën rreth 367.000.000 euro, kurse faza e dytë e projektit kap shumën 788.000.000 euro, që përfshin mbikëqyrjen e punëve implementuese. Në total kostoja e këtyre shërbimeve kap shumën (për pjesën e linjës, që kalon nëpër Kosovë) 1.155.000.000 euro

Ndikimet e këtij projekti madhor, me rastin e ndërtimit, janë:

- Shtimi i kapaciteteve transmetuese në rajon
- Mundësimi i alokimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga TC Kosova e Re
- Optimizimi i operimit të dy sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe të Shqipërisë – (operimi komplementar)
- Përmirësim i eficiencës së punës së dy sistemeve elektroenergjetike
- Rritja e rrjetit horizontal për KOSTT-in
- Rritja e kapaciteteve bartëse përmes rrjetit transmetues
- Programimi i burimeve hidro-termo në mënyrë optimale dhe shitblerjet e energjisë që bëjnë të mundshme uljen e shpenzimeve vjetore të operimit
- Ulja e shpenzimeve për rezervën e gatshme dhe për rezervën në qarkullim për dy sistemet elektroenergjetike që punojnë së bashku.
- Një programim më eficient dhe një shfrytëzim më i mirë i burimeve ujore, si rrjedhojë e uljes së konsumit specifik të ujit për çdo kWh të prodhuar nga hidrocentralet.
- Ulja e pikut të sistemit të përbashkët për shkak të jonjëkohëshmerisë së kërkesës maksimale dhe për rrjedhojë ulja e kërkesës për kapacitete shtesë për të mbuluar pikun.
- Një programim më eficient dhe një shfrytëzim i burimeve termike për shkak të rritjes së rendimentit të punës të kaldajave dhe të turbinave që punojnë në një rregjim pune optimal
- Një rritje të sigurisë së punës së sistemeve.

Në kuadër të Planit Zhvillimor dhe Investues të KOSTT-it është paraparë edhe ndërtimi i Linjës 400 kV, Kosovë – Maqedoni.

“Bashkëpunimi i ynë me KOSTT daton që nga ditët e para kur u themelua si Operator i ri i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut. Pas përfundimit të suksesshëm të Nënstacionit Peja 3, ne kemi zgjeruar bashkëpunimin tonë financiar me KOSTT edhe me një investim të madh kapital-ndërtimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri - si dhe dy studime, në zgjerimin e rrjetit si dhe rregullimin frekuencë-fuqi.

Kur shikojmë prapa, pa dyshim se qelësi i kryesor i suksesit të bashkëpunimit tonë ka qenë përkushtimi i jashtëzakonshëm si dhe profesionalizimi i KOSTT.”

Zhvillimet e infrastrukturës për kontroll dhe monitorim

Projekti SCADA/EMS dhe Telekomimi

Në kuadër të infrastrukturës për monitorim dhe kontroll, KOSTT-i është në fazën e zbatimit të Projektit SCADA/EMS, i cili përfshin Qendrën Kryesore Dispeçerike (Q. D.) dhe Qendrën Emergjente Dispeçerike (Q.E.D.), SCADA lokale me RTU në 24 nënstacione të nivelit 110 kV, realizimin e SCADA me mbrojtje në NS Prizreni 2 dhe ndërlidhjen e SCADA-ve ekzistuese në 9 nënstacione të niveleve të ndryshme të tensionit me Q.D. dhe Q.E.D. I tërë komunikimi ndërmjet nënstacioneve me Q.D. dhe Q.E.D. duhet të zhvillohet përmes protokollit IEC 104.

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar 80% të trajnimeve, është kryer pranimi teknik në fabrikë apo FAT (Factory Acceptance Test) i SCADA/EMS dhe është në fazën e realizimit Q.E.D. I tërë projekti pritet të përfundojë në dhjetor 2010.

Në anën tjetër, Sistemi telekomunikues ka për detyrë të ofrojë rrugë transmetuese komunikuese të sigurisë së lartë, për këmbimin e të dhënave dhe të bisedave ndërmjet objekteve elektroenergjetike dhe Qendrave kontrolluese (kryesore dhe emergjente), për sistemet dhe funksionet e mëposhtme:

- SCADA/EMS që lidhet me kontrollin e rrjetit transmetues elektroenergjetik, përfshirë këtu kontrollin e trafostacioneve
- Matjet e tensionit të lartë (HVM)
- Komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave në largësi dhe i vlerave të matura me qendrat nacionale kontrolluese të vendeve fqinje

Nënsistemet kryesore të cilat mundësojnë funksionet e lartpërmendura janë:

- Lidhjet telekomunikuese të cilat përdorin sistemin me fije optike në përçuesin e tokëzimit (OPGW), radiosistemin mikrovalor si dhe sistemin PLC
- Pajisjet multiplekse dhe ndërmjetësuese për grumbullimin e të dhënave dhe bisedave dhe lidhjen e tyre me pajisjet transmetuese telekomunikuese
- Pajisjet komutuese (PBX) për ndërlidhje telefonike, të linjave lidhëse dhe të rrjetit publik telefonik.

Gjatë vitit 2009 në kuadër të:



Projektit SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni, janë instaluar mbi 200 km kablo optik të tipit OPGW (Optical Ground Wire). Këto kablo mundësojnë njëkohësisht mbrojtjen e rrjetit elektrik dhe transmetimin e sinjaleve telekomunikuese nëpër fijet optike, me performanca shumë të larta. Qëllimi është që deri në fund të vitit 2010 të realizohet rrjeti optik elastik “backbone network” me pajisjet SDH të cilat punojnë me kapacitet të lartë, deri në STM-4.



Pasqyrë e operimit të sistemit elektrik të Kosovës në vitin 2009

Pas një periudhe shumë të gjatë të përforcimeve jo të mjaftueshme në rrjetin e Transmisionit, viti 2009 paraqet kthesë vendimtare për rrjetin e Transmisionit. Projekti madhor Peja 3 paraqet përforcimin me ndikim mjaft të lartë për rrjetin e transmisionit të Kosovës. Ky paketë-projekt ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së bartjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në një zonë mjaft të gjerë të rrjetit të transmisionit.

“Sistemit të transmisionit i është mundësuar rritje e kapacitetit transformues prej 270 MW, duke ndikuar në shkarkimin e autotransformatorëve në NS Kosova B, NS Kosova A dhe NS Prizreni 2 dhe në optimizmin e rrjedhave të fuqisë në një numër të madh të linjave 110 kV.

Ndikim mjaft pozitiv i këtij projekti është reduktimi i ndjeshëm i humbjeve të fuqisë aktive dhe reaktive në rrjet, si dhe përmirësimi i profilit të tensionit në një pjesë të madhe të nyjave shpërndarëse, me theks të veçantë në zonën e Dukagjinit.

Duke pasur parasysh që edhe pjesa tjetër e rrjetit të Transmisionit, përkatësisht pjesa juglindore e tij, nuk ka qëndruar mirë në aspektin e performancës operative





dhe të sigurisë së rrjetit, KOSTT, duke u bazuar në Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit 2007-2013, ka përfunduar projektin e konvertimit të linjës 220 kV të dëmtuar (jofunksionale) L212 në linjë 110kV dhe kyçjen e saj në nyjën shumë të rëndësishme në NS Ferizaj (Bibaj). Ky projekt ka mundësuar optimizmin e rrjedhave të fuqisë edhe në pjesën juglindore të rrjetit të Transmisionit. Me injektim të drejtpërdrejtë nga nyja e fuqishme NS Kosova A, përmes kësaj linje është arritur përmirësim tejet i madh i profilit të tensioneve, reduktim i humbjeve dhe shkarkim i linjës problematike 110 kV Prishtina 4 – Ferizaj (Bibaj). Gjithashtu efektet e këtij projekti kanë ndikim edhe më të gjerë, duke përmirësuar cilësinë e furnizimit për një pjesë të konsiderueshme të konsumit (Ferizaj, Sharri, Vitia, Gjilani dhe Theranda). Projekti tjetër shumë i rëndë-


sishëm në rrjetin e Transmisionit i cili ka përfunduar në vitin 2009 është instalimi i autotransformatorit 150 MVA. 220/110 kV në NS Kosova A, i cili ka zëvendësuar autotransformatorin me defekt AT1 100 MVA. Projekti ka ndikuar në rritjen e kapacitetit, të sigurisë dhe të besueshmërisë operuese të nënstacionit NS Kosova A, duke eliminuar fytin e ngushtë në transformim.

Ndërkohë në shtator të vitit 2009 ka përfunduar projekti i përforcimit të linjës 110 kV Deçan – Gjakova 1, me ç'rast linjës i është rritur kapaciteti i bartjes nga 83 MVA në 114 MVA, pas ndërrimit të përçuesve. Kjo linjë paraqet degë të rëndësishme të unazës Gjakova 2 – Gjakova 1 – Deçan – Peja 2 – Peja 1 – Peja 3 dhe përforcimi i saj ka ndikuar në reduktimin e elementeve të cilat nuk plotësojnë kriterin N-1 por gjithashtu ka ndikuar edhe në reduktimin e humbjeve aktive dhe reaktive

në rrjetin e Transmisionit. Ndikimi i projekteve të përforcimit të rrjetit të Transmisionit 2009, kategorizuar sipas kriterëve teknike nga Kodi i Rrjetit janë:

- Rritja e kapaciteteve bartëse (transmetuese) për 34% krahasuar me kapacitetin aktual
- Rritja e kriterit të sigurisë N-1*** për 31%
- Përmirësim i ndjeshëm i profilit të tensioneve në nyjat 110 kV
- Reduktim i ndjeshëm i humbjeve aktive dhe reaktive
- Rritje e mundësive për optimizmin e rrjedhave të fuqisë aktive dhe reaktive në rrjetin e Transmisionit

Bazuar në konkludimet e mësipërme, rrjeti i Transmisionit ka nevojë për përf forcime të mëtutjeshme ashtu që të mund të përcjellë rritjen e konsumit, gjenerimin, gjithmonë duke plotësuar kriteret teknike në pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit. Rritja e kapaciteteve të transmisionit në varësi nga koha shihet më së miri në fig 11.



*** Kriteri N-1 nënkupton se nëse cilido element i rrjetit linjë ose transformator është jashtë punës furnizimi nuk çrregullohet






Gjithashtu shihet që edhe humbjet në transmision kanë qenë më të vogla gjatë vitit 2009 sesa ato gjatë vitit 2008, gjë që tregon efikasitetin e shtuar të punës së sistemit të transmisionit. Humbjet në baza mujore për vitin 2008 dhe 2009 janë paraqitur në diagramin e mëposhtëm.

Bilanci i realizuar 2009 krahasuar me 2008

Siç shihet nga tabela, prodhimi, konsumi, ngarkesa maksimale ka qenë më i madh gjatë vitit 2009 se sa gjatë vitit 2008.



Energjia e pafurnizuar 2007-2009

Në tabelën dhe diagramin e mëposhtëm është paraqitur energjia me të cilën është dashur të furnizohet konsumatori fundor, por nuk është furnizuar, për shkak të rënieve të stabilimenteve apo për shkak të punëve gjatë implementimit të projekteve të kryera nga KOSTT, për vitet 2007, 2008 dhe 2009.

2007	Gjithsej
Energjia e pafurnizuar (MWh)	11470
Konsumi (MWh)	4678 985
Energjia e pafurnizuar (%)	0.245
2008	
Energjia e pafurnizuar (MWh)	11166
Konsumi (MWh)	5012 667
Energjia e pafurnizuar (%)	0.222
2009	
Energjia e pafurnizuar (MWh)	11462
Konsumi (MWh)	5420 211
Energjia e pafurnizuar (%)	0.211

Tab.8 Energjia e furnizuar dhe pafurnizuar




Fig 13. Energjia e pafurnizuar 2007-2009



Tregu i energjisë elektrike të Kosovës

Rrjedhat fizike nëpër Rrjetin Transmetues të KOSTT për vitin 2009






Fig 14. Rrjedhat fizike nëpër Rrjetin Transmetues të KOSTT për vitin 2009

Madhësia e tregut të energjisë elektrike në Kosovë

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg kryesisht i rregulluar. Konsumatori i vetëm i cili në Kosovë e shfrytëzon të drejtën e konsumatorit të kualifikuar është NewCo Ferronikeli, i cili e ka të drejtën e zgjedhjes së Furnizuesit. Raporti i energjisë së tregtuar në tregun e rregulluar ndaj energjisë së tregtuar në tregun e parregulluar është paraqitur në diagramin e mëposhtëm:



¹ Konsumi total i energjisë elektrike përfshin edhe prodhimin e hidrocentralit të Lumbardhit pasi ky hidrocentral gjeneron në rrjetin distributiv, si dhe nuk shkakton humbje në transmision.

Konsumi tarifor në diagramin e mësipërm është i matur në kufirin TSO – DSO dhe rrjedhimisht përfshin edhe humbjet e përgjithshme në distribucion.





Fig 17. Konsumi jotarifor & konsumi tarifor bashkë me humbjet ne distribucion 2009

Bilanci i realizuar i Rrjedhave të Energjisë në rrjetin transmetues për periudhën janar '09 - dhjetor '09

Në figurën 18 është dhënë bilanci i rrjedhave të energjisë nëpër rrjetin transmetues të KOSTT-it për vitin 2009. Nga energjia totale që ka hyrë në rrjetin transmetues të KOSTT-it rreth 59 % është nga gjenerimi vendor, rreth 31.5 % në formë të transitit ndërsa rreth 9 % si import për nevoja të konsumit të Kosovës.


Rreth 63 % e energjisë që ka dalë nga rrjeti transmetues i KOSTT-it i është dedikuar konsumit të Kosovës dhe humbjeve në distribucion, 31.5 % ka qenë në formë transiti, 3.3% ka qenë në formë eksporti nga gjenerimi në Kosovë dhe rreth 2% të saj kanë qenë humbje në rrjetin transmetues të KOSTT-it.





Barazimi përfundimtar i palëve në treg

Një ndër obligimet kryesore të Operatorit të Tregut si operator i licencuar është edhe barazimi përfundimtar i palëve në treg. Palë pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për vitin 2009 kanë qenë katër gjeneratorë (TC Kosova A, TC Kosova B, HC Ujmani dhe HC Lumbardhi), një furnizues (KEK Furnizimi) dhe 12 tregtarë/ furnizues me shumicë (ATEL, CEZ, EFT, EGL, ELEM, EPCG, EZPADA, GEN I-SLO, KESH, RAETIA, RE Trading CE dhe RUDNAP). Njëherazi pala dominante në tregun e energjisë elektrike ishte KEK Furnizimi



Çmimi mesatar i energjisë elektrike dhe importi i energjisë elektrike

Krahasuar me vitin 2008, importi i energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2009 ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e shkallës së reduktimeve në rreth 52 %². Nga muaji gusht deri në muajin dhjetor zvogëlimi i çmimit mesatar të energjisë elektrike në sistemin e Kosovës është bërë për arsye të zvogëlimit të kërkesës në rajon, të ndikuar drejtpërdrejt nga kriza ekonomike.

Çmimi mesatar i energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2009 ka qenë 25.78 €/MWh, ndërsa çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike në Kosovë ka qenë 75.9 €/MWh.




Fig 20. Krahasimi i çmimit mesatar të importit të energjisë elektrike 2008/ 2009






Fig 21. Krahasimi i çmimit mesatar të energjisë elektrike për vitin 2008/ 2009


². Kjo përfaqëje është nxjerrë nga ditari dispeçerik i vitit 2008 dhe 2009



Transiti i energjisë elektrike


Transiti i energjisë elektrike për vitin 2009 nëpër territorin e Kosovës krahasuar me vitin e mëparshëm është zvogëluar kryesisht për arsye të topologjisë së re të krijuar të rrjetit të Evropës Juglindore me largpërçuesin 400 kV ndërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë (shiko figurën 23).

Edhe më tutje KOSTT-i nuk është duke u kompensuar për transitin e energjisë elektrike nëpër rrjetin e tij. KOSTT bazuar në marrëveshjet e përkohshme, është duke i dërguar faturat Operatorit Serb - EMS për kompensimin e transimit, mirëpo deri me tash asnjë faturë nuk është paguar nga ana e EMS. Shuma totale e pretenduar për transit për vitin 2009 të cilën EMS duhet t'i paguajë KOSTT-it është e rendit 1.4 milionë euro.



Humbjet e energjisë në transmision

Si rezultat i operimit më eficient, si dhe vendosjes së grupeve të reja matëse dhe lëshimit në punë të NS Peja 3 (400/110 kV), humbjet në vitin 2009 janë dukshëm më të vogla se në vitin e mëparshëm. Humbjet në total në vitin 2009 kanë qenë për 17 % më të vogla se në vitin e mëparshëm.



Reformat në tregun e energjisë elektrike në Kosovë

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është menduar të zhvillohet në disa faza, varësisht nga zhvillimet dhe reformat në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë dhe zhvillimet në tregjet rajonale. Modeli aktual i tregut në Kosovë është një model bilateral tranzicional me një numër të vogël të pjesëmarrësve në treg, ku KEK-u luan rol dominant në gjenerimin dhe furnizimin me energji elektrike. Zhvillimet momentale në sektorin e energjisë, si: procesi drejt privatizimit të distribucionit dhe furnizimit, nxitja e investitorëve për investime në projektin Kosova e Re dhe anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E⁴ kërkojnë kalimin nga faza ekzistuese e modelit të tregut në një fazë më të avan-

cuar, që implikon dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike, i cili do të ishte gjith-ashtu në harmoni me kërkesat që dalin nga TKE⁴.

KOSTT-i gjatë vitit 2009 ka marrë pëlqimin dhe instruksionet e nevojshme për të filluar me procesin e modifikimit të Rregullave të Tregut që do t'i përshtateshin reformave të cilat parashihen të ndodhin pas shturjes së KEK-ut, gjegjësisht privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit dhe Gjenerimit. Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2010 dhe KOSTT-i së bashku me palët e interesit dhe këshilltarët e transaksioneve do të jetë aktiv në dizajnimin e një modeli të ri të tregut.

Pas miratimit të dizajnit të tregut nga Qeveria e Kosovës, Operatori i Tregut do të bëjë modifikimin e Rregullave të Tregut për të krijuar kushte transparente dhe jodiskriminuese të tregutit me energji elektrike ndërmjet palëve në treg.

³ ENTSO-E – (European Network of Transmission System Operators for Electricity), asociacion i TSO-ve të Evropës i formuar me bashkimin e asociacioneve të mëparshme UCTE, ETSO/SETSO TF, Nordel, UKTSOA, BALTSO, ATSOI

⁴ TKE Traktati i komunitetit të energjisë



Integrimet rajonale

Në vitin 2009 është formuar asociacioni i ri, i quajtur ENTSO-E. KOSTT-i para themelimit të ENTSO-E ishte anëtarë i SETSO TF⁵, Task Force që vepronte nën ombrellën e ETSO⁶ dhe kishte rol të rëndësishëm në aktivitetet që zhvilloheshin në EUL përmes nëngrupeve NACMPF⁷, BM⁸, ITC⁹ dhe CAO IG¹⁰. Për të vazhduar aktivitetet e SETSO TF, është themeluar grupi rajonal i EUL, i quajtur RG SEE, nën ombrellën e MC¹¹ të ENTSO-E. KOSTT dhe ATSO¹² kanë statusin e vëzhguesit në grupin RG SEE dhe nuk kanë të drejtë vote. Kjo pozitë është duke e vështirësuar procesin drejt integritit të KOSTT-it në mekanizmat rajonalë përkundër rezultateve të arritura gjatë vitit 2008.

Në muajin korrik 2009 përfaqësuesit e KOSTT-it kanë mbajtur një takim në Komisionin Evropian (DG TREN) dhe në ENTSO-E ku janë diskutuar problemet dhe vështirësitë e integritit të KOSTT-it në mekanizmat rajonalë dhe anëtarësimi i

KOSTT-it në ENTSO-E. Në takimin e mbajtur në ENTSO-E përfaqësuesi i Komisionit Evropian deklaroi se nuk ka pengesa ligjore që KOSTT-i të anëtarësohet në ENTSO-E dhe për më tepër KOSTT-i si TSO palë kontraktuese e komunitetit të energjisë duhet të përmbushë obligimet që dalin nga legjislacioni Evropian, e në veçanti obligimet që dalin nga Rregullorja 1228/2003.

Një nga objektivat kryesorë të KOSTT-it është anëtarësimi në ENTSO-E. Për këtë qëllim KOSTT-i gjatë vitit 2009 ka ndërmarrë një mori aktivitetesh për ta përmbushur këtë objektiv. KOSTT-i ka bërë vlerësimin e kushteve dhe të standardeve që duhet plotësuar për anëtarësim në ENTSO-E dhe ka zhvilluar procedurat e nevojshme të parapara me UCTE OH¹³. Edhe më tutje KOSTT-i është ballafaquar me shumë vështirësi, të cilat kanë ardhur si rezultat i vazhdueshëm i pengesave dhe obstrukcioneve të EMS – operatorit serb, i cili është duke i shkaktuar dëme të mëdha KOSTT-it dhe sektorit të

energjisë elektrike në Kosovë. Ankesa formale që KOSTT-i ka dorëzuar në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në gusht 2008, kundër Serbisë si palë kontraktuese dhe që i referohet abuzimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë nga Serbia në implementimin e Rregullores 1228/2003 për qasje në rrjet dhe tregti ndërkufitare, nuk është zgjidhur ende. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë është duke u marrë me çështjen dhe ka organizuar takime ndërmjet KOSTT-it, MEM-it të Serbisë dhe EMS-së në mënyrë që të gjenet një kompromis në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

ENTSO-E



KOSTT



⁵ SETSO TF Southeast European TSOs Task Force – Trupi Veprues i OST-ve i EUL i cili vepron nën ombrellën e ETSO-ve.

⁶ ETSO - European Transmission System Operators

⁷ NACMPF - Network Access Congestion Management Power Flow - nëngrup për menaxhimin e kongjestionëve

⁸ BM - Balancing Market

⁹ ITC - Inter TSO Compensation

¹⁰ CAO IG - Coordinated Auction Office Implementation Group – Grupi Implementues për themelimin e Zyrës rajonale për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve

¹¹ RG SEE - është grup rajonal nën ombrellën e MC – Market Committee – Komiteti i tregut i ENTSO-E dhe i cili do të merret me çështjet e tregut në EUL

¹² ATSO - TSO e Shqipërisë

¹⁴ UCTE OH – Operational handbook – përmbledhje e parimeve dhe rregullave që duhet të zbatohen TSO-të e Evropës për operimin e sistemeve elektroenergetike



Menaxhimi i burimeve njerëzore

KOSTT me 31 dhjetor të vitit 2009 ka numëruar gjithsej 218 punëtorë apo 8.95% më shumë se sa në vitin paraprak. Kur merret parasysh veprimtaria e KOSTT është evidente që gjinia mashkullore dominon në strukturën gjinore të punonjësve me 80.73%, derisa femrat përbëjnë 19.27% të punonjësve. Nga numri i përgjithshëm i punonjësve në KOSTT 35.32% janë inxhinier.

Numri i të punësuarve në KOSTT	Viti 2008		Viti 2009		% (rritja)	
	201		218		8.95	
Struktura e të punësuarve sipas gjinisë	Viti 2008			Viti 2009		
Meshkuj	159	79.1%	176	80.73%		
Femra	42	20.9%	42	19.27%		
Struktura kualifikuese e punonjësve	Viti 2008			Viti 2009		
PSP (me përgatitje superiore profesionale)	M	73	36.32%	M	73	33.49%
	F	27	13.43%	F	27	12.39%
PL (me përgatitje të lartë)	M	4	1.99%	M	4	1.83%
	F			F		
KL (me kualifikim të lartë)	M	11	5.47%	M	14	6.42%
	F			F		
PMP (me përgatitje të mesme profesionale)	M	70	34.82%	M	83	38.1%
	F	11	5.47%	F	11	5.1%
PK (të pakualifikuar)	M	1	0.49%	M	1	0.45%
	F	4	1.99%	F	4	1.83%
KU (me kualifikim të ulët)	M	1	0.49%	M	1	0.46%
	F			F		
Struktura sipas profesionit me PSP	Viti 2008			Viti 2009		
Inxhinierë	77	38.3%	77	35.32%		
Ekonomistë	14	6.96%	14	6.82%		
Juristë	7	3.48%	7	3.21%		
Me Fakultet të Filologjisë/Gjuhë Shqipe	2	0.99%	2	0.91%		
Mosha mesatare e të punësuarve	43 vjet			44 vjet		
Lëndime në punë	4 raste			7 raste		

Tab 9. Të dhënat e Burimeve Njerëzore të KOSTT-it për vitin 2008/2009



Ngritja e kapaciteteve njerëzore në KOSTT

Edhe gjatë vitit 2009 KOSTT ka zhvilluar procesin e trajnimeve duke investuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, një buxhet prej rreth **139,000 €**, ku janë përfshirë rreth 180 persona.



Me qëllim të zhvillimit profesional dhe përcjelljes së zhvillimeve të reja teknologjike inxhinierët e KOSTT-it gjatë vitit 2009 janë përfshirë në një numër të konsideruar të trajnimeve.

Këtë e tregon edhe Indikatori i cili është më i madh se vitin e kaluar për 76.5% (nga 3.28 në 5.79). Aktivitetet kryesore të këtij sektori në fushën e trajnimeve gjatë vitit 2009 janë fokusuar në zhvillimin e shkathtësive profesionale. Trajnimet kryesore që janë realizuar gjatë vitit 2009 janë si vijon:

1. Trajnimet e karakterit teknik

- Në lëmin e telekomunikacionit dhe SCADA-s
- Trajnimet në kuadër të projektit SCADA/EMS & Telekomunikacion
- Trajnimet për grupet matëse, mbrojtje rele në kuadër të projekteve të rrjetit të trans-misionit

2. Trajnimet e karakterit ekonomik-komercial

- Trajnimi "Menaxhimi i Aseteve"
- Trajnimi "Rregullimi i çmimeve dhe Tarifat"
- Trajnimi mbi rregullat e kontratave të FIDIC-ut (FIDIC Contracts)
- Vijimi i seminarit "Përmbledhje e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar".

3. Trajnimet e karakterit që rrisin eficiencën e operimit të kompanisë

- Trajnimi "Menaxhimi i Performancës, Motivimi dhe Zhvillimi"
- Trajnimi rreth praktikave të korporatave dhe protokolleve që i përkasin atyre
- Menaxhimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe vlerësimi i brendshëm sipas ISO 9001:2008
- Vijimi i kursit për kompjuter për 11 punëtorë

Përveç kësaj, gjatë vitit 2009, me qëllim të sjelljes së përvojave nga kompanitë e avancuara, stafi ynë ka marrë pjesë në udhëtimin studiues në Mbretërinë e Bashkuar, në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga ZNKO.

Teknologjia Informative në KOSTT

Infrastruktura dhe tërë sistemi i Teknologjisë Informative (TI) në KOSTT është relativisht e re, e ngritur sipas teknologjisë së fundit të TI-së, e sistemuar dhe e konfiguruar sipas standardeve bashkëkohore.

Kjo infrastrukturë shfrytëzohet nga një numër i konsiderueshëm i kompjuterëve personalë dhe nga një numër i konsiderueshëm i pajisjeve të tjera ndihmëse që janë në shërbim të shfrytëzuesve të KOSTT-it, e që krijojnë një strukturë të centralizuar, hierarkike, të modelit klient-server, e cila menaxhohet, monitorohet, mbrohet dhe mirëmbahet nën mbikëqyrjen e personelit të TI-së.

Ruajtja e shënimeve dhe informatave të rëndësishme të KOSTT-it bëhet në makina (serverë) adekuatë për ruajtjen e shënimeve, të cilat sipas procedurave mirëmbahen dhe arkivohen në baza të rregullta kohore.

Për mbarëvajtje të shërbimit të kontabilitet, financave dhe burimeve njerëzore, KOSTT-i disponon me bazën e shënimeve CAS (Computerized Accounting System – Sistemi i Kompjuterizuar i Kontabilitetit) duke ofruar mundësinë elektronike të menaxhimit të shënimeve dhe të të dhënave lidhur me resorët e përmendur të KOSTT-it. KOSTT-i disponon edhe me bazën e shënimeve TAS (Time Attendance System) që bën ruajtjen dhe arkivimin elektronik të prezencës kohore të punonjësve të KOSTT-it.



“Komunikimi i brendshëm dhe ai i jashtëm bëhet përmes e-mailit zyrtar exchange.kostt.com, kurse publikimi i informatave të cilësuar si të hapura për publikun, por edhe informatave të mbrojtura dhe të dedikuara vetëm palëve të treta dhe personave të autorizuar nga KOSTT bëhet përmes faqes elektronike www.kostt.com

Shërbimi i pandërprerë i Internetit sigurohet përmes realizmit të një lidhjeje primare të Internetit dhe të një lidhjeje tjetër sekondare, e cila aktivizohet në mënyrë automatike në rast të dështimit të lidhjes primare.

Me qëllim të mbarëvajtjes së sistemit të automatizuar për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive, sjelljes ndaj sistemit të TI-së dhe komunikimit me palët e treta, KOSTT-i ka përpiluar politikat dhe procedurat përkatëse.

Sistemi i TI-së ofron përkrahje edhe për projekte të tjera në KOSTT përmes infrastrukturës aktuale dhe aplikacioneve ekzistuese.



Raportet financiare të audituara

Bilanci i Gjendjes 31.12.2009, Tabela 10

		Më 31 dhjetor 2009 Shënimet (në EUR 000)	Më 31 dhjetor 2008 (në EUR 000)
MJETET			
MJETET JOQARKULLUESE			
Prona, Impiantet dhe Pajimet	4	75,195	43,295
Mjetet e tjera të paprekshme	5	46	61
		<u>75,241</u>	<u>43,356</u>
Mjetet qarkulluese (kapitali punues)			
Stoqet	6	1,016	1,257
Mjetet e arkëtueshmet tregtare	7	10,200	7,576
Mjetet e arkëtueshme të tjera	8	8,504	10,506
Paraja në bankë dhe në arkë	9	9,137	4,360
		<u>28,857</u>	<u>23,699</u>
MJETET (AKTIVA) TOTALE		<u>104,098</u>	<u>67,055</u>
EKUITETI DHE OBLIGIMET			
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	10	25	25
Premiumet aksionare	11	28,347	28,347
Fitimet e mbajtura		10,786	3,853
		<u>39,158</u>	<u>32,225</u>
Detyrimet joqarkulluese			
Grantet e shtyra	12	57,362	30,038
Detyrimet qarkulluese			
Detyrimet e pagueshme tregtare dhe të tjera	13	7,578	4,792
		<u>64,940</u>	<u>34,830</u>
EKUITETET DHE OBLIGIMET (Pasiva) TOTALE		<u>104,098</u>	<u>67,055</u>

Autorizuar për lëshim nga Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve dhe nënshkruar në emër të tij më 13 maj 2010.

Z. Fadil Ismajli

Z. Nebih Haziri

Kryeshef Ekzekutiv

Zyrtar Kryesor Financiar


Bilanci i Gjendjes është një nga pasqyrat financiare që tregon pozicionin financiar (Aktivet, Pasivet dhe Kapitalin) të Kompanisë në një datë të caktuar.

Krahasuar me vitin e mëparshëm, ka pasur rritje në këto pozicione:

- Mjetet joqarkulluese për 74%
- Mjetet qarkulluese (Kapitali punues) për 22 %
- Ekuiteti i aksionarëve për 22%
- Detyrimet e pagueshme për 58%
- Grantet e shtyra për 90%

Kjo tregon se gjatë vitit 2009 KOSTT sh.a për investime kapitale në pjesën më të madhe ka shfrytëzuar grante qeveritare dhe grante të tjera.



Viti 2009 është viti i parë kur KOSTT sh.a një pjesë të investimeve kapitale e ka financuar me mjete nga aktivitetet operative duke u bazuar në rritjen e të hyrave operative, krahasuar me rritjen e shpenzimeve operative.



Pasqyra e të hyrave, Tabela 11

Janar- dhjetor 2009	Shënimet	Më 31 dhjetor 2009 (në EUR000)	Më 31 dhjetor 2008 (në EUR 000)
Të hyrat operative			
Transmisioni i energjisë	14	20,061	15,212
Të hyra të tjera	15	1,196	647
		21,257	15,859
Minus: Shpenzimet operative			
Kosto e stafit	16	2,338	1,982
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5	3,001	2,221
Riparime dhe mirëmbajtje	17	918	1,144
Humbjet nga transmisioni i energjisë		5,212	5,258
Shpenzimet e tjera operative	18	1,001	774
Rregullimi sekondar		996	986
Energjia, telefoni dhe uji		225	150
Derivate dhe lubrifikante		79	83
Materiale		32	51
		13,802	12,649
Fitimi para tatimit		7,455	3,210
Tatimi në fitim	19	522	-
Fitimi neto për vitin		6,933	3,210
Të hyra të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Total të hyra të tjera gjithëpërfshirëse		6,933	3,210

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve është një nga pasqyrat financiare që tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet dhe fitimin/humbjen) e Kompanisë gjatë një periudhe kontabël. Krahasuar me vitin e mëparshëm, të hyrat operative janë rritur për 34 %, ndërsa shpenzimet operative janë rritur për 9%.



Investimet e bëra në rrjetin e transmisionit, kanë ndikuar në reduktimin në masë të madhe të shpenzimeve nga humbja e energjisë në transmision, përkundër faktit që gjatë këtij viti kemi pasur rrjedha më të mëdha të energjisë se në vitin e mëparshëm.

Fitimi bruto kap vlerën prej 7,455 mijë euro dhe fitimi neto, pas tatimit, 6,933 mijë euro.

Pasqyra e ndërrimeve në kapital më 31 dhjetor 2009, Tabela 12

	Kapitali aksionar	Premiumi i aksionarëve	Fitimet e mbajtura	TOTAL
	------(në EUR 000)-----			
Bilanci më 1 janar 2008	25	28,332	643	29,000
Fitimi gjatë vitit	-	-	3,210	3,210
Shtime	-	15	-	15
Bilanci më 31 dhjetor 2008	25	28,347	3,853	32,225
Fitimi gjatë vitit	-	-	6,933	6,933
Bilanci më 31 dhjetor 2009	25	28,347	10,786	39,158

Pasqyra e ndryshimeve në kapital është një nga pasqyrat financiare që tregon ndryshimet në kapitalin e Kompanisë gjatë një periudhe kontabël.

Pasqyra e rrjedhës së parasë, më 31 dhjetor 2009, Tabela 13

Shënimet	Më 31 dhjetor 2009	Më 31 dhjetor 2008
	(në EUR 000)	(në EUR 000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi gjatë vitit		6,933
Përshtatur për:		3,210
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5	3,001
Të hyrat nga interesi	15	(219)
Shlyerja e mjeteve, impianteve dhe pajimeve	4	18
Të hyrat nga grantet	12	(890)
Fitimi operativ pas përshtatjeve		8,843
Zvogëluar (rritur) në stoqe		241
Rritje në kërkesa nga tregtia		(2,624)
Zvogëluar (rritur) në kërkesa të tjera		2,001
Rritur në pagueshmëri tregtare dhe të tjera		2,786
Gjenerimi i parasë nga aktivitetet operative		11,247
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive		410
Interesi i pranuar		219
Investime në Prona, Impiante dhe Pajime		(20,892)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive, neto		(20,673)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		14,370
Grantet e pranuar		15,181
Grantet e kthyer		(978)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare, neto		14,203
Ndryshimet neto të parasë		4,777
Paraja në fillim të vitit	9	4,360
PARAJA NË FUND TË VITIT	9	9,137

Pasqyra e rrjedhës së parasë është një nga pasqyrat financiare që tregon rrjedhën e parasë (arkëtimet dhe pagesat në para dhe në ekuivalent të parasë) të Kompanisë gjatë një periudhe kontabël.

Bazuar në rrjedhat e parasë, kompania KOSTT sh.a. gjatë vitit 2009 ishte mjaft likuide edhe përkundër investimeve të mëdha në aktivitetet investive.

Ngjarjet që kanë shënuar vitin 2009

JANAR

KOSTT dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë me 30 janar nënshkruan Marrëveshjen për implementimin e projektit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë - Shqipëri. Projekti për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë - Shqipëri konsiston në ndërtimin e një linje të tensionit të lartë 400 kV me gjatësi rreth 238 km, prej së cilës 85.5 km në territorin e Kosovës dhe 153.5 km në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, u nënshkrua edhe Marrëveshja e Interkoneksionit ndërmjet KOSTT Kosovë dhe OST Shqipëri.

SHKURT

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli me bashkëpunëtorë, me 27 shkurt realizuan një vizitë zyrtare në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Malit të Zi (PRENOS Crna Gora) në Podgoricë. Në këtë takim të bashkëpunimit teknik, kompanitë simotra diskutuan për disa çështje teknike me interes të dyanshëm si dy sisteme fqinje, si dhe u dakorduan për themelimin e grupeve punuese për çështjet teknike të diskutuara. Ndërkaq në fillim të dhjetorit delegacioni nga Mali i Zi vizitoi KOSTT-in dhe me këtë rast u diskutua rreth mundësive të avancimit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy operatorëve.


MARS

KOSTT sh.a, para palëve të interesit të sektorit të energjisë më 12 mars prezantoi planet për zhvillimin afatmesëm të kapaciteteve të transmisionit të Republikës së Kosovës. Në bazë të planit zhvillimor afatmesëm të KOSTT, me implementimin e projekteve të planifikuara dhe përfundimit të atyre në implementim, parashikohet rritje e dukshme e kapaciteteve bartëse.



PRILL

Pas dorëzimit të aplikacionit përfundimtar për shqyrtimin e tarifave nga KOSTT me datën 18 janar 2009, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka analizuar dhe shqyrtuar përfundimisht aplikacionet dhe ka marrë vendimin për Miratimin e tarifave dhe ngarkesave të transmissio­nit për t'u aplikuar nga KOSTT nga data 1 prill 2009.

**MAJ**

Në kuadër të përkushtimit të KOSTT për zhvillimin e rrjetit të transmissio­nit të Republikës së Kosovës, gjatë muajve prill dhe maj 2009 u implementua projekti për ndërrimin e përcuesve të linjës 110 kV (kilovolt) LP 126/1 që lidh Nënstacionin NS 110/35 kV Deçani me NS Gjakova. Qëllimi i implementimit të këtij projekti në vlerë prej 1.079.925.00 Euro, i cili u financua nga buxheti i KOSTT, është eliminimi e fyteve të ngushta në rrjetin e transmissio­nit, e me këtë sigurimi i furnizimit më cilësor nga aspekti i transmissio­nit në Rajonin e Dukagjinit.

**QERSHOR**

Bazuar në Ligjin e ri për ndërmar­rjet publike nr. 03/L-087, më 2 qer­shor të vitit 2009 u mbajt takimi i parë i Bordit të ri të Drejtorëve të KOSTT, në përbërje prej: z. Faton Deda, kryesues, z. Fadil Ismajli, anëtar - drejtor menaxhues i KOSTT, z. Fadil Rrustemi, anëtar, z. Fatos Ukaj, anëtar, z. Lutfi Maxhuni, anëtar, z. Nazmi Mikullovc, anëtar dhe z. Ramadan Paçarada, anëtar. Në takimin e parë konstitu­ues, KOSTT-i prezantoi para anëtarëve të Bordit të Drejtorëve punën e deritashme të kompanisë, si dhe të akteve të aplikueshme që rregullojnë veprimtarinë e KOSTT-it.

Me 25 qershor 2009 në takimin e 13 të Grupit Permanent të Nivelit të Lartë në Sarajevë (ang. PHLG-Per­manent High Level Group)/organ i Komunitetit të Energjisë për E­JL, janë paraqitur qëndrimet e KOSTT lidhur me çështjet që ndërlidhen me zhvillimet e tregut, Raportin e Bankës Botërore, mbështetja e KOSTT për themelimin e CAO, studimi për zhvillimin dhe theme­limin e Menaxhimit të Koordinuar të Kongjestio­nit – ku është kërkuar që sistemi i Kosovës të paraqitet ndaras në pajtim me kornizën gjeografike të Traktatit

01
prill

1.079.925.00
euro



KORRIK

Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur më 23 korrik 2009, pas kërkesës së KOSTT sh.a ka miratuar dokumentin "Plani Zhvillimor i Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007 – 2013"

Me 7 korrik 2009 janë mbajtur takime të ndara me përfaqësuesit e DGTREN dhe ENTSO-E në Bruksel. Qëllimi i takimeve ishte që këtyre institucioneve të i'u shpjegohen zhvillimet në KOSTT lidhur me integrimet në mekanizma ndërkufitar dhe anëtarësimin në ENTSO-E. Në takimin me DG TREN u konkludua se KOSTT duhet të punoj në plotësimin e kriterëve teknike për anëtarësim dhe të bëhet aplikimi për ENTSO-E.

Ndërkaq përfaqësuesit e ENTSO-E ishin mjaft të interesuar lidhur zhvillimet në KOSTT dhe konkluduan se edhe takime tjera duhet organizuar, sidomos para procesit të aplikimit në mënyrë që të qartësohen kërkesat procedurale dhe teknike që nevojiten para dhe gjatë aplikimit.

Me 29 korrik Komisioni Evropian i dërgoi letër Kryesuesit të ENTSO-E ku shprehë mbështetjen e plotë të Komisionit për anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E.

**Plani Zhvillimor
i Sistemit të Transmisionit
të Kosovës
2007 – 2013**

**DGTREN
dhe
ENTSO-E**

GUSHT

KOSTT në vitin 2009 ka realizuar me sukses projektin për servisimin e rregullatorëve të tensionit në disa Nënstacione: NS 220/110 kV Prizreni 2, NS 220/110 kV Prishtina 4, NS 220/110 kV Kosova A, i cili është implementuar nga kompania Konçar nga Kroacia. Realizimi i servisimit të rregullatorëve të tensionit është pjesë e rëndësishme e mirëmbajtjes së pajisjeve të rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike. Ky servisim është e paraparë të bëhet çdo 6 (gjashtë) vjet. Realizimi i servisimit të rregullatorëve të tensionit, në radhë të parë ndikon në jetëgjatësinë e pajisjeve, e gjithashtu edhe në ngritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit.

**Ngritja e
jetëgjatësisë
së pajisjeve**

SHTATOR

Në praninë e autoriteteve më të larta të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeverisë Gjermane dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, më 24 shtator, është nënshkruar kontrata për shërbime të konsulencës për linjën interkonektive 400 kV Kosovë - Shqipëri

Po më 24 shtator është zbuluar pllaka falënderuese për Republikën Federale të Gjermanisë dhe Republikën e Kosovës, si bashkëfinancuese të projektit për ndërtimin e Nënstacionit 400/110 kV (kilovolt) Peja 3.



TETOR

Nën organizimin e Alb - Konfindustrisë, KOSTT-it dhe KEK-ut, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, veçanërisht të ministres Justina Shiroka-Pula, më 5 dhe 6 tetor u mbajt Forumi Ndërkombëtar "Kosova – Një Mundësi Energjetike". Forumi Ndërkombëtar i Energjisë ishte vend ku u takuan përfaqësues dhe ekspertë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë të energjetikës, të cilët patën mundësinë të zhvillojnë diskutime rreth çështjeve energjetike dhe ku u prezantuan mundësitë që i ofron Kosova për investitorët potencialë.



NËNTOR

Në afërsi të Istogut, në praninë e delegacionit të lartë të Qeverisë së Kosovës, Ambasadës Gjermane dhe akterëve kyç vendorë dhe ndërkombëtarë të sektorit të energjisë, më 17 nëntor u bë inaugurimi i Nënstacionit 400/110/10.5 kV Peja 3, me ç'rast Kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaçi energjizoi solemnisht Nënstacionin. Nënstacioni Peja 3 tashmë është më modern në Kosovë dhe njëherazi është Nënstacioni i parë dhe më i rëndësishmi që është ndërtuar në sistemin e transmissiionit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës që nga vitet '80.



DHJETOR

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala, drejtoresha rajonale për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) znj. Ute Rodrian dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli, më 23 dhjetor, në Prishtinë, nënshkruan Marrëveshjen për Kredi dhe Financim të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri. Marrëveshja parasheh një buxhet prej 33,5 milionë euro, nga të cilat 17,0 milionë euro janë kredi komerciale afatgjatë, me kushte kredituese të buta dhe 16,0 milionë euro janë grant i Qeverisë Gjermane.

Më 13 dhjetor 2009, në orën 19:00, është shënuar piku i transmetimit të energjisë elektrike prej 1072 MW.



**piku i transmetimit
të energjisë
elektrike
prej 1072 MW.**

Përgatitja e Raportit Vjetor 2009 koordinuar nga:

Naim Bejtullahu, zv. KSHE për zhvillim
Zana Bajrami-Rama, menaxhere për komunikim

Me kontributin e punonjësve të KOSTT:

Arjeta Gashi, Azem Kastrati, Besim Gërxhaliu, Bukurije Dauti, Fëllënza Xhelili, Gazmend Kabashi, Gjokë Karaqi, Gonxhe Haziri, Ibrahim Gashi, Ilir Shala, Jusuf Imeri, Kadri Kadriu, Kimete Fazliu, Labinot Gashi, Merita Kostari, Musa Kadriu, Nadire Klaiqi, Nagip Syla, Naim Bejtullahu, Nasip Bresilla, Nebih Haziri, Nergize Reznici, Resmije Ahma, Rexhep Gerguri, Sabri Musiqi, Sadudin Havolli, Safete Orana, Sahit Halimi, Shaban Neziri, Sherif Dedaqi, Shpresa Kursani, Shukrije Fetahaj, Skender Gjonbalaj, Visar Hoxha, Vjosa Reznici, Xhavit Sadiku, Zana Bajrami-Rama, Zera Ymeri

Fotografitë: KOSTT sh.a (përveq fq: 1, 14, 18, 28, 38, 44, 51, 60)

Dizajni dhe radhitja: Ashagraphics

Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregut - KOSTT sh.a

Rr. Iljaz Kodra pn
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: + 381 (0) 38 501 601 5

Fax: + 381 (0) 38 500 201

E-mail: info@kostt.com

Web: www.kostt.com

*E shtypur në korrik 2010
Publikimi nuk është për shitje*

*Në kuader të raportit vjetor
FILMI DOKUMENTAR: KOSTT - "NJË RRËFIM I SUKSESSHËM"*

www.kostt.com

